



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 853 Prot.

Tiranë, më 12 .07. 2023

### V E N D I M

#### Nr.128, Datë 12 .07. 2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>2</sup>, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr. 143 Regj, datë 20.09.2022, paraqitur nga ankuesi P.S, ku pretendohet diskriminim për shkak të “bindjes filozofike”, “gjendjes arsimore”, “përkatësisë në një grup të veçantë” dhe “çdo shkak tjetër”, nga ana Prof. Dr. S.G, Rektore e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, z. R.D, Kryetar i Këshillit të Etikës pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, znj. V.ZDrejtoreshë e Drejtorisë Juridike, pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe znj. E.Sh, Administratore e këtij Universiteti.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

### K O N S T A T O I:

#### I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Mbështetur në shpjegimet e dhëna në ankesë, rezulton se ankuesi P.S punon në pozicionin e pedagogut pranë Fakultetit të Ekonomik, të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër. Punësimi i tij është bërë i mundur në kuadër të projektit *Brain Gain*. Ankuesi pretendon se diskriminimi i tij nga ana e strukturës drejtuese të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, është e lidhur me disa ngjarje të ndodhura në këtë universitet, si pasojë e ankesës së një studenteje ndaj tij, për një ngjarje të stisur.

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

Përsa më sipër, ankuesi sqaron se në datën 15.07.2021, ora 10:02, studentja e masterit profesional E.V. është paraqitur pranë zyrës së tij dhe ka kërkuar informacion nëse ishte kaluese në lëndën e Menaxhimit Bankar. Z. S sqaron se në prani të Shefes së Departamentit i ka lexuar studentes vlerësimin jokalues, ndërkohë që ajo sapo ka marrë dijeni mbi rezultatin, ka filluar ta kërcënojë duke ngritur zërin dhe duke i bërë presion se nëse nuk i vinte notë kaluese do të ndikonte nëpërmjet njohjeve të saj në MASR, për ta larguar nga puna, duke aluduar se kishte informacion për paligjshmëri në punësimin e tij. Situata është tensionuar dhe ankuesi ka njoftuar policinë, e cila nuk i është përgjigjur. Në vijim, ai sqaron se ka qenë i detyruar të filmojë me celular, të gjithë situatën me studenten, për ta referuar çështjen tek eprorët, si dhe pranë Komisarariatit të Policisë Shkodër. Në vijim, ankuesi pretendon se ka telefonuar sërish policinë duke kërkuar ndërhyrjen e saj.

Në orën 14:00, të së njëjtës ditë, ankuesi pretendon se është telefonuar nga Dekania e Fakultetit të Ekonomisë, e cila ka informuar se studentja E.V. e kishte marrë në telefon dhe i kishte referuar ngjarjen e ndodhur, si dhe e kishte informuar se e kishte denoncuar z. S, në polici, pasi është mbetur shumë herë në provim dhe se është goditur nga mbyllja e derës së zyrës së tij. Ankuesi sqaron se është paraqitur në polici bashkë me avokatin e tij, duke parashtruar provat që konsistojnë në filmimet e kryera nëpërmjet celularit, si dhe duke shpjeguar dhe sqaruar se ngjarja në fjalë ishte e stisur.

Në mbrëmje, ankuesi pretendon se ka njoftuar me e-mail eprorët e tij dhe drejtuesit e institucionit, duke i bërë me dije mbi ngjarjen e ndodhur, si dhe duke u kërkuar që t'i vihen në dispozicion filmimet e kamerave në ambientet e fakultetit, në mënyrë të vërtetonte faktin se ai asnjëherë nuk e kishte goditur studenten, duke mbyllur derën e zyrës. Njëkohësisht, sipas verifikimeve që ankuesi ka kryer, ka rezultuar se ankuesja ishte e regjistruar në vitin 2016 për të kryer masterin profesional dhe nuk kishte frekuentuar asnjëherë leksionet apo seminarët e lëndës së Menaxhimit Financiar, duke mos patur të drejtë për pjesëmarrje në provim sipas Rregullores së Universitetit. Sipas të dhënave të administruara rezultonte që në vitin 2020 studentja ishte regjistruar 3 (tre) herë në provimin e lëndës Menaxhim Financiar dhe asnjëherë nuk ishte paraqitur në provim. Hera e vetme, kur ajo ishte paraqitur në këtë provim, ishte data 06.07.2021, ku kishte marrë 14 pikë, të pamjaftueshme këto, për të qenë kaluese. Pas kryerjes së verifikimeve të nevojshme, ankuesi pretendon se e ka kuptuar që kjo ngjarje ishte e stisur, me qëllim për ta denigruar, pasi studentja kishte deklaruar në polici se pedagogu i lëndës e kishte mbetur 8 herë në provim.

Z. S pretendon se ka depozituar ankesë në Këshillin e Etikës, ndaj veprimeve të studentes dhe në vijim ka dërguar disa kërkesa nëpërmjet emailit zyrtar drejtuar Rektores dhe Administratores së Univerisitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për të patur akses në filmimet e kamerave të fakultetit, me qëllim zbardhjen e situatës konkrete. Z. S sqaron se titullarët e sipërcituar nuk i kanë kthyer përgjigje. Në këto kushte, ankuesi pretendon se 6 (gjashtë) ditë më vonë ka patur takim me Rektoren e Universitetit, ku pasi i ka treguar filmimet e tij, ka kërkuar që të hapen kamerat, për të qartësuar situatën, pasi edhe familjarët e tij mund të shqetësoheshin nga një ngjarje e tillë. Ankuesi pretendon se Rektoria nuk ka pranuar hapjen e kamerave dhe është shprehur se studentja e ka vënë në dijeni nëpërmjet aplikacionin *WhatsApp*, mbi ngjarjen e ndodhur. Një fakt i tillë e ka çuditur z.

S, i cili thekson faktin se edhe ai vetë në cilësinë e pedagogut nuk mund t'i drejtohet Rektores, përveçse nëpërmjet *e-mailit* zyrtar, ndërkohë që një studente ka akses për të komunikuar në celular me titullaren e Universitetit.

Ankuesi pretendon se në datën 30.08.2021, Këshilli i Etikës e ka njoftuar me *e-mail* për një takim në datën 02.09.2021. Edhe pse ishte me pushime vjetore, ankuesi pretendon se është paraqitur në takim, qëllimi i së cilit ka qenë zbardhja e ankesës së studentes E.V. kundër tij. Ndërkohë që, ankesa e z. S ndaj studentes nuk ishte përcjellë nga Rektorja e Universitetit drejt Këshillit të Etikës, i cili nuk kishte dijeni mbi informacionin e pedagogut mbi ngjarjen e ndodhur. Në këtë mbledhje, ankuesi ka treguar *e-mailin* e tij drejtuar Rektores së Universitetit, si dhe u ka shfaqur filmimet e tij për ngjarjen e ndodhur në datën 15.07.2021. Ndërkohë, që nga Këshilli i Etikës i është bërë e ditur që studentja është dëmtuar nga përplasja me derën e zyrës dhe për këtë është lëshuar Raport nga mjeku ligjor. Njëkohësisht, ankuesit i'u bë e ditur se ankuesja ka informuar këtë Këshill, se ndaj pedagogut ka edhe 5 (pesë) denoncime të tjera në polici. Ankuesi ka mohuar gjithçka duke theksuar se këto fakte nuk janë të vërteta dhe ka kërkuar sërish hapjen e kamerave në datën e ngjarjes, për zbardhjen e së vërtetës, sikurse për të vërtetuar që në të njëjtën datë, është ndaluar nga një person i panjohur (femër) në ambientet e fakultetit, e cila i është prezantuar si motra e studentes E.V. dhe ka kërkuar nga ana e tij që ta kalonte të motrën në provim. Këshilli i Etikës e ka përfunduar mbledhjen duke sqaruar se do të kontaktohet sërish për mbledhjen e radhës.

Në vijim, ankuesi pretendon se në mbrëmjen e së njëjtës ditë ka parë njërën nga anëtarët e Këshillit të Etikës, përkatësisht znj. B.L, të ulur në kafene me studenten E.V. dhe motrën e saj. Ai pretendon se i ka folur znj. Lufi, duke i vënë në dukje faktin se qendrimi i saj me studenten E.V. përbën konflikt interesi. Në vijim, z. S i është drejtuar sërish Këshillit të Etikës dhe ka kërkuar informacion zyrtar mbi ankesën e studentes, si dhe për arsyet e mos dërgimit për shqyrtim të ankesës së tij nga Rektorja e Universitetit. Këshilli i Etikës nuk i ka dërguar përgjigje.

Pas kthimit nga pushimet, ankuesi sqaron se në mëngjesin e datës 07.09.2021 ka hapur *e-mailin* zyrtar, nga ku është njoftuar nëpërmjet një shkrese të Rektores së Universitetit drejtuar Fakultetit Ekonomik, se studentja E.V. ka kërkuar që në provimin e Menaxhimit Financiar të mos bëjnë pjesë në komision pedagogët e lëndës dhe përgjegjësja e Departamentit. Këtë ankesë, Rektorja e kishte gjetur të drejtë dhe u kërkonte drejtuesve të Fakultetit Ekonomik, që të zbatonin kërkesat e studentes, me pretendimin se z. S ishte në konflikt interesi, pasi ishte palë në një proces gjyqësor me studenten, si dhe për shkak të armiqësisë që kishte me të.

Përsa më sipër, ankuesi pretendon se shkresa e Rektores është në kundërshtim me Rregulloren e Universitetit, pasi anëtarët e komisionit të provimeve janë vetëm monitorues të ecurisë së provimit dhe provimet korrigjohen në mënyrë të sekretuar. Në këtë kontekst, ankuesi shprehet se nuk e ka kuptuar se ku qëndron konflikti i tij i interesit me studenten. Shkresa e Rektores e konsideronte të drejtë kërkesën e studentes, ndërkohë që z. S pretendon se nuk kishte asnjë njoftim nga gjykata për një proces gjyqësor me studenten. Shkresa e Rektores ishte protokolluar në Rektorat në datën

25.08.2021, ndërkohë që në Fakultetin Ekonomik kishte marrë numër protokollit në datën 03.09.2021.

Ankuesi sqaron se sipas Rregullores për Konfliktin e Interesit, është Këshilli i Etikës, autoriteti, i cili mund ta deklarojë këtë konflikt dhe në vijim koordinon punën me zyrën juridike duke njoftuar palët. Ndërkohë që, në rastin konkret, Rektorja e ka paragjykuar duke i dhënë një vendim fajësie në mënyrë të njëanshme dhe ka marrë kompetenca që nuk i takojnë me ligj, duke pranuar ankesën e studentes dhe duke marrë atributet e Këshillit të Etikës. Ankuesi shprehet se punon prej 12 vjetësh në Fakultetin Ekonomik dhe në asnjë rast nuk ka ndodhur ndryshimi i Komisionit të Provimit ose caktimi i një date provimi vetëm për një student. Z. S pretendon se shkresa e Rektores ishte paragjyquese dhe diskriminuese, pasi krijonte një precedent të rëndë për 506 studentë të tjerë, jo kalues, në provimet e lëndëve, në të cilat ai është lektor, pasi ata mund të ndjekin të njëjtën strategji dhe të kërkojnë ndërrimin e komisionit të provimit. Njëkohësisht, ai sqaron se nuk mund të punojë i qetë në kushtet kur, çdo student mund të paraqitet tek dera e zyrës së tij dhe të pretendojë për dëmtim/ ofendim /armiçësi/ inate personale dhe të paraqesë ankesë tek Këshilli e Etikës, apo të kërkojë ndërrimin e komisionit të provimit, pa pritur që Këshilli të shprehet me vendim.

Ankuesi sqaron se para provimit ka paraqitur një kërkesë tek Këshilli i Etikës, ku ka kërkuar informacion mbi faktin, nëse ky autoritet është shprehur me vendim për konflikt interesi ose vendim fajësie në lidhje me të. Këshilli i Etikës ka sqaruar se nuk është shprehur me vendim lidhur me rastin e tij. Njëkohësisht, ankuesi sqaron se ka verifikuar listat e studentëve që do të marrin pjesë në provim dhe ka konstatuar se studentja E.V. nuk ishte regjistruar për të marrë pjesë në provim. Për këtë arsye, ai ka deklaruar se nuk ka patur asnjë konflikt interesi dhe është paraqitur normalisht në provim. Ankuesi vë në dukje faktin se para zhvillimit të këtij provimi është mbledhur Departamenti i Financë-Kontabilitetit për të shqyrtuar kërkesën e studentes së bashku me shkresën e Rektores. Ky Departament ka marrë vendim që komisionet e provimit të mos ndërrohen. Vetëm pas mbërritjes së shkresës së Departamentit të Financë Kontabilitetit dhe Këshillit të Etikës, pedagogu P.S pretendon se është paraqitur për të marrë pjesë në komisionin e provimit. Pas përfundimit të provimit, Dekani i Fakultetit Ekonomik i ka përcjellë një ankesë të studentes, të cilën ajo e kishte depozituar në përfundim të provimit të Menaxhimit Financiar. Ankuesi sqaron se pasi ka lexuar ankesën me kujdes, ka paraqitur para Këshillit të Etikës dhe titullarëve të institucionit sqarimet kërkatëse, edhe pse nuk i ishin kërkuar.

Në datën 05.09.2021, studentja E.V. ka depozituar padi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku ka paditur pedagogun P.S për “dhunë në familje” dhe ka kërkuar që gjykata të lëshojë urdhër mbrojtje dhe të vendosë që ankuesi të mbajë një distancë 100 m nga ajo, duke bërë deklaram të rremë, sikur pedagogu është në proces zgjidhje martese dhe se banon në të njëjtën adresë me të. Z. S pretendon se nuk e njeh fare studenten E.V. dhe nuk e ka parë asnjëherë në 5 vite, përgjatë së cilëve ajo ka ndjekur masterin pranë Fakultetit Ekonomik. Ajo ka pretenduar për përndjekje nga ana e tij, por në oraret e përcaktuara nga studentja, ankuesi pretendon se ka qenë në shtëpi, ku është edhe i regjistruar nga kamerat përkatëse. Z. S sqaron se gjykata e ka hedhur poshtë kërkesën e studentes, pasi ai rezulton i martuar dhe kërkesa e saj ishte e pambështetur.

Në datën 14.09.2021, pedagogu është njoftuar për t'u paraqitur në takim zyrtar me Rektoren, Zv. Rektoren, e Universitetit të Shkodrës, Dekanen dhe Përgjegjësen e Departamentit të Fakultetit Ekonomik. Objekti i takimit ishte kërkesa e studentes për ndërrimin e komisionit të provimit, sepse në datën 22.09.2021 ishte provimi i Modelimit Financiar, në të cilin z. S ishte pedagog i dytë. Në këtë takim, ankuesi e ka njoftuar Rektoren mbi procesin gjyqësor të sipërcituar, duke theksuar faktin se studentja kishte tentuar të mashtronte gjykatën. Njëkohësisht, ankuesi shprehet se ka vënë në dukje faktin se në provimin e datës 07.09.2021, studentja nuk ishte paraqitur, ndërkohë që në provimin e datës 22.09.2022, ai ishte në cilësinë e pedagogut të dytë dhe mund të tërhiqej nga pjesëmarrja në komisionin e provimit. Z. S pretendon se Rektorja ka kërkuar që të caktohej një datë tjetër provimi për lëndën e Menaxhimit Financiar, vetëm për studenten E.V., duke ndërruar komisionin. Ankuesi e ka kundërshtuar këtë vendim, duke theksuar faktin se nuk ekziston konflikti i interesit dhe se këtë konflikt mund ta përcaktojë vetëm Këshilli i Etikës. Debatu ndërmjet tyre mbi studenten E.V. ka vijuar më tej, ku Rektorja ka urdhëruar verbalisht Dekanen e Fakultetit Ekonomik të ndryshojë Komisionin e Provimit. Ankuesi pretendon se Zv. Rektorja është shprehur se vetëm Këshilli i Etikës ka tagër të vendosë mbi konfliktin e interesit, si dhe nuk mund të procedohej me një datë të veçantë provimi për studenten E.V., si dhe të ndryshohej komisioni i provimit, pasi një gjë e tillë mund të përbëjë precedent të rëndë për të gjithë studentët e tjerë. E gjendur para një situatë të tillë, Rektorja ka vendosur që të pritet për vendimin e Këshillit të Etikës, i cili duhet të miratohej para provimit të lëndës së Modelimit Financiar. Në rast se ky Këshill do të shprehej kundër ankuesit, komisioni i provimit do të ndryshohej. Z. S shprehet se Rektorja e Universitetit është shprehur qartë për të ndikuar në veprimtarinë e Këshillit të Etikës, si dhe për të shpejtuar vendimmarrjen e tij. Gjatë këtij takimi, ankuesi ka sqaruar se në asnjë rast nuk ka reaguar ndaj ofendimeve dhe kërcënimeve të studentes duke ruajtur etikën profesionale. Ai thekson faktin se në çdo veprim të kryer nga ana e tij ka zbatuar Rregulloren e provimeve dhe ka deklaruar se ngjarja është e stisur nga studentja, vetëm që pedagogu i lëndës të përjashtohej nga komisionet e provimeve, në të cilat ajo nuk ishte përgatitur.

Pas takimit me Rektoren, ankuesi sqaron se ka dërguar ankesë pranë Këshillit të Etikës, ku ka kërkuar që të ishte prezent në mbledhjen e ardhshme të tij, ndërkohë që Kryetari i këtij këshilli e ka njoftuar se procesi i mbledhjes së provave dhe pyetjes së dëshmitarëve ka përfunduar dhe se ky këshill do të mbledhej për të marrë një vendim. Ankuesi pretendon se përfundimi i procedimit në mënyrë të menjëhershme pas takimit me Rektoren, është një provë e qartë se ajo ka ndërhyrë duke kërkuar marrjen e një vendimi të shpejtë. Z. S shprehet se edhe pse ka kërkuar për t'u paraqitur pranë këtij Këshilli, me qëllim depozitim të provave shtesë, një kërkesë e tillë nuk i është pranuar.

Këshilli i Etikës është shprehur me vendimin nr. 291/2021, ku është marrë në shqyrtim vetëm ankesa e studentes dhe jo e pedagogut P.S. Në këtë vendim, Këshilli ka dalë në përfundim se pretendimet e studentes nuk qëndrojnë dhe kjo vendimmarrje është mbështetur në analizimin e përmbajtjes filmike të kamerave të universitetit dhe pyetjes së dëshmitarëve. Ankuesi sqaron se pavarësisht kësaj, Këshilli nuk është shprehur me një vendimmarrje përfundimtare mbi çështjen, por ka vendosur ta pushojë çështjen.

Në datën 04.10.2021, z. S shprehet se ka depozituar kërkesë për informacion për të marrë një kopje të ankesës, materialeve të dosjes, akteve, provave, filmimeve të kamerave, në mënyrë që të informohej zyrtarisht për çështjen. Ai pretendon se Këshilli i Etikës nuk i ka kthyer përgjigje. Në vijim, z. S pretendon se ka depozituar sërish kërkesë me shkrim duke kërkuar një përgjigje mbi dy ankesat e mëparshme ndaj studentes, si dhe ka depozituar një ankesë të re për marrje masash administrative ndaj saj, pasi Këshilli i Etikës kishte vërtetuar që ngjarja nuk kishte ndodhur.

Në vijim të kërkesave të tij drejtuar Këshillit të Etikës, Rektorja e Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, në datën 08.10.2021, ka bërë një mbledhje urgjente në Rektorat, ku pas diskutimit të çështjeve në rendin e ditës, ka kërkuar miratimin e tre datave të reja për provime, vetëm për studenten E.V. Në përfundim të mbledhjes nuk është gjetur e mundshme për të vendosur data provimesh, për shkak të përfundimit të strukturës mësimore të miratuar nga MAS. Ankuesi sqaron se në këtë mbledhje, Rektorja ka dhënë komente negative mbi të, duke paragykuar punën e tij. Z. S pretendon se duke vlerësuar veprimet e Rektores, të cilat janë në kundërshtim me ligjin, duke kërkuar favorizimin ekstrem të studentes, ka kuptuar se procesi i Këshillit të Etikës është i influencuar nga titullarja e universitetit. Kamerat janë bllokuar qëllimisht dhe ankesa e tij nuk është dërguar për shqyrtim pranë Këshillit të Etikës, në mënyrë që studentja të mos pezullohej dhe t'i ofrohej mundësia e diplomimit të shpejtë të saj. Ankuesi pretendon se Rektorja dhe anëtarët e Këshillit të Etikës janë përfshirë në këtë ngjarje, për ta penalizuar atë duke përdorur studenten, të cilën kanë tentuar ta favorizojnë në të gjitha mënyrat.

Përveç sa më sipër, ankuesi sqaron se veprimet diskriminuese të Rektores së Universitetit kanë vazhduar edhe në vijim. Kështu, ankuesi sqaron se në datën 14.10.2021 është mbledhur Asambleja e Pedagogëve për të diskutuar çështjen e uljes së numrit të studentëve (sidomos në degën e mësuesisë) që frekuentojnë Universitetin, duke kërkuar reagim nga institucioni. Në cilësinë e anëtarit të kësaj përfaqësie, z. S ka mbajtur një fjalim, ku ka kërkuar që Senati Akademik të fillojë një proces gjyqësor kundër MAS, për të kundërshtuar caktimin e mesatares së lartë për pranimin e studentëve. Në mbledhje kanë folur edhe pedagogë të tjerë, të cilët kanë ngritur akuza për punë të dobët të kolegëve të Universitetit, në përpilimin e programeve të reja studimore për të aplikuar pranë MAS. Z. S sqaron se mbledhja është mbyllur pa votim, sepse është vendosur që propozimet e përfaqësisë të dërgohen për miratim në secilin fakultet, në mënyrë që të shpreheshin të gjithë kolegët e universitetit.

Në datën 15.10.2021, është raportuar se Ministria e Arsimit dhe Sportit ka reaguar duke deklaruar se nuk ka refuzuar takimin me asamblenë e pedagogëve dhe është e gatshme për takim. Pas këtij lajmi, në orën 18:00, ankuesi sqaron se Rektorja e Universitetit ka njoftuar për takim urgjent me përfaqësinë e asamblesë. Në këtë mbledhje, ankuesi pretendon se Rektorja është shprehur shumë keq në adresë të tij, duke theksuar faktin se “*ankuesi ka cënuar universitetin ku merr rrogën*”, si dhe se ka bërë gabim që ka lexuar të dhënat mbi numrin e studentëve. Në vijim i është tërhequr vëmendje mbi faktin se ka ftuar mediat në këtë takim. Ndërkohë që, Dekani i Fakultetit Juridik i është drejtuar personalisht duke vënë në dukje faktin se kolegët e Fakultetit Ekonomik kanë votuar

kundër Rektores aktuale në zgjedhjet e vitit 2020 dhe se tani nuk duhet të flasin për çështjen e mesatares, por të japin dorëheqjen nga detyra që mbajnë aktualisht.

Për sa më sipër, ankuesi sqaron se në mbledhjen e Asamblesë ka patur edhe pedagogë të tjerë të cilët kanë folur dhe kanë evidentuar problematika të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, por titullarja e universitetit ka vënë në dukje vetëm fjalimin e tij. Në këtë takim, ankuesi sqaron se ka kundërshtuar Rektoren e Universitetit duke i thënë se në cilësinë e pedagogut, ai ka të drejtë të shprehet lirisht mbi politikat e ndjekura nga institucioni. Z. S pretendon se është shprehur para Rektores se nëse janë të vendosur ta largojnë nga puna për shkak të qëndrimeve të tij publike, janë të lirë ta kryejnë një gjë të tillë, pasi ai nuk tërhiqet nga deklaratat e tij, të cilat i ka konsideruar se janë në të mirën e universitetit dhe qytetit të tij.

Në përfundim, z. S shprehet se mbledhja është mbyllur pa i komunikuar vendimin e organit kolegjal, edhe pse ai ka pyetur disa herë mbi vendimmarrjen e tyre. Ai sqaron se nuk ka informacion nëse ndaj tij është iniciuar ndonjë procedurë për vërejtje, por cilëson se kjo është një situatë e përsëritur diskriminuese, që tregon që Rektorja e Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, vepron ndryshe kundrejt tij, duke krijuar situata që tentojnë ta frikësojnë me vërejtje të mundshme dhe tentojnë të ulin figurën e tij para kolegëve.

Ankuesi P.S sqaron se diskriminimi i tij nga subjektet e sipërcituara është i bazuar dhe ka si shkak formimin e tij si një student i diplomuar në një universitet perëndimor dhe fitues i Programit “Brain Grain”. Ankuesi shprehet se nuk pranon ndërhyrje nga të tretët për favorizimin e studentëve në provime dhe nuk pranon të vendosë notë kaluese të pamerituar ndaj tyre. Ai thekson faktin se si pasojë e formimit të tij nuk pranon dhe ka kundërshtuar çdo politikë të gabuar të drejtuesve të Universitetit, Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Njëkohësisht, ankuesi e bën me dije KMD-në se ka kundërshtuar gjithashtu vendimet e dhëna në kundërshtim me ligjin nga komisioni *ad hoc* në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, që kanë sjellë penalizimin e Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, nga KMD, nëpërmjet vendimit nr. 166, datë 14.11.2019 dhe vendimit nr. 187, datë 16.12.2019<sup>3</sup>. Ankuesi e informon KMD-në, se i ka kërkuar Senatit Akademik të ndërpresë menjëherë paligjshmërinë duke respektuar vendimet e Komisionerit dhe për këtë arsye është kërcënuar nga institucioni me shkresë zyrtare, pasi ai është personi i parë që ka konstatuar aplikimin e një dispozite të shfuqizuar të rregullores së studimeve dhe ka vënë në dijeni titullarët e institucionit mbi një fakt të tillë.

Për sa më sipër, ankuesi sqaron se Rektorja aktuale e Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër ka mbajtur pozicionin e Dekanes në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe njëkohësisht të senatores në Senatin Akademik, përgjatë periudhës kohore kur ai ka paraqitur ankesën e tij pranë këtij Senati, ndërsa znj. B.L, aktualisht anëtare e Këshillit të Etikës, ka qenë e emëruar në cilësinë e anëtares së komisionit *ad hoc* që ka kryer shkelje të natyrës ligjore.

---

<sup>3</sup> Në vendimet e cituara, KMD është shprehur me vendim diskriminimi ndaj Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për ankuesen L.Dh., e cila është e afërme e z. Saraçi;

Ankuesi thekson faktin se subjektet kundër së cilëve drejtohet ankesa e kanë diskriminuar për shkaqet e shënuara në ankesë, pasi ai ka kundërshtuar Bordin e Administrimit, Administratoren, Senatin Akademik dhe Rektoren për shkeljen e të drejtave të studentëve në mosfrimin e ngrohjes për studentët e programit master si dhe rastet e llogaritjes gabim të tarifave për studentët e Fakultetit Ekonomik. Këto ankesa, ankuesi sqaron se i ka bërë publike, duke vërtetuar se shpenzimet për ngrohjen janë fiktive dhe nuk dihet destinacioni i tyre.

Ai shprehet gjithashtu se ka kundërshtuar Senatin Akademik për interpretimin e gabuar të ligjit për arsimin e lartë, në bazë të së cilit studentët e masterit profesional janë detyruar të paguajnë tarifa shtesë për certifikatën e gjuhës së huaj. Ankuesi sqaron gjithashtu se ka kundërshtuar keqmenaxhimin e universitetit nga dekanët e fakulteteve, të cilët nuk kanë vepruar për të mënjanuar rënien e numrit të studentëve, duke rrezikuar mbylljen e degëve të tij. Ai sqaron se në daljet e tij publike ka përmendur Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe Fakultetin e Shkencave të Natyrës, duke konsideruar se rënia drastike e numrit të studentëve në degët e mësuesisë ka ardhur menjëherë nga zbatimi i mesatares së lartë në kundërshtim me praktikën e vendeve të rajonit. Në daljet e mëparshme në media, ai sqaron se nuk është thirrur asnjëherë nga drejtuesit e universitetit, ndërsa në datën 15.10.2021, sapo ka reaguuar MAS, ai është thirrur në mbledhje urgjente në Rektorat, duke e kërcënuar për fjalimin e tij në asamble, pasi ky fjalim është transmetuar në media. Në këtë takim, ankuesi sqaron se i është kërkuar dorëheqja nga detyra që mban, me arsyetimin se fakulteti, ku ai bën pjesë ka votuar kundër Rektores aktuale.

Përveç sa më sipër, ankuesi sqaron se ndërmjet drejtuesve të Universitetit dhe anëtarëve të Këshillit të Etikës ekziston konflikt interesi me studenten E. V. Ai thekson faktin se studentja E.V. ka lidhje shoqërore dhe familjare me anëtarin e Këshillit të Etikës, B.L dhe me Rektoren S.G. Për këtë arsye, studentja është favorizuar duke mos trajtuar asnjë nga ankesat e paraqitura nga ai, ndaj saj.

Ankuesi sqaron gjithashtu se shkak tjetër diskriminimi është edhe përkatësia e tij në shtresën e të përndjekurve politikë, pasi nëna e tij është mbesa e të ndjerit Qazim Mulleti, ish Prefektit të Tiranës dhe në çdo rast, çdo e drejtë e fituar nga ana e tij, i hiqet padrejtësisht nga MAS. Në vitin 2019, ankuesi sqaron se ka fituar si kandidat në Bordin e Administrimit Financiar (votuar nga studentët) dhe është anashkaluar pa asnjë shkak të ligjshëm nga MAS, e cila ka zgjedhur një kandidat, i cili nuk plotësonte asnjë kriter ligjor. Në këtë çështje, KMD është shprehur me vendim diskriminimi<sup>4</sup> dhe çështja është kundërshtuar gjyqësisht nga MAS, ku palë e paditur ka qenë edhe Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

Shkaqet e sipërcituara, ankuesi P.S i lidh në mënyrë të drejtpërdrejtë me reagimin e Këshillit të Etikës ndaj tij, duke sqaruar faktin se 6 muajt e fundit ka depozituar tre ankesa, të cilat nuk janë trajtuar nga ky autoritet. Njëkohësisht, ai sqaron se nuk i është ofruar asnjë dokument nga ana e Universitetit, për të kuptuar ankesën e studentes E. V., si dhe i kanë mohuar të drejtën për të patur akses në filmimet e kamerave apo për të dorëzuar prova shtesë në Këshillin e Etikës.

---

<sup>4</sup> Referuar vendimit nr. 135, datë 02.10.2019, dhënë mbi ankesën nr. 95, datë 05.08.2019, të z. Peter Saraçi kundër MASR.



Ankuesi pretendon se diskriminohet për shkaqet e përmendura më sipër nga Rektorja S.G, lidhur me sa më poshtë vijon:

1. Ka penguar hapjen e kamerave të godinës së Fakultetit Ekonomik, për të penguar zbardhjen e ngjarjes së ndodhur në datën 15.07.2021;
2. Nuk ka përcjellë ankesën e tij në Këshillin e Etikës. (Rektorja drejton mbledhjet e Këshillit të Etikës dhe ka propozuar 5 (pesë) anëtarët e këtij Këshilli pa titullin e kërkuar ligjërisht);
3. Ka dërguar një shkresë paragjyquese dhe në kundërshtim me ligjin dhe duke influencuar punën e Këshillit të Etikës;
4. Nuk i ka dërguar asnjë informacion dhe nuk ka kthyer asnjë përgjigje për shkresat që z. S i ka dërguar, ndërkohë që studentes E. V. i ka kthyer përgjigje brenda afatit 10 ditor;
5. Ka ndikuar tek Këshilli i Etikës, që të ndërpresë procedimin administrativ, për të dhënë një vendim sa më të shpejtë, për të favorizuar studenten ankuese, me të cilën ka njohje familjare dhe nuk e ka deklaruar;
6. Nuk ka deklaruar konfliktin e interesit me studenten E.V;
7. Ka tentuar të caktojë data provimi vetëm për studenten ankuese;
8. Ka vënë në rrezik jetën e një kolegu, si pasojë e bllokimit të kamerave të universitetit. Në këtë mënyrë ka favorizuar haptazi studenten, sepse që në datën 15.07.2021 mund të hapeshin kamerat dhe të njoftohej policia lidhur me ngjarjen;
9. Me veprimet e saj e ka kërcënuar duke krijuar një ambient frikësues në punë, duke cënuar dinjitetin e tij dhe duke e poshtëruar para dekanëve të fakulteteve, kolegëve dhe studentëve. Këto sjellje kanë patur si qëllim, që ankuesi të ndryshojë mënyrën e korrigjimit të provimeve në kundërshtim me rregulloren e fakultetit;
10. Ka thirrur mbledhje të Rektoratit, për t'i bërë gjyq publik z. S, lidhur me diskutimin e tij si përfaqësues i Fakultetit Ekonomik në Asambleenë e Përgjithshme të pedagogëve, duke e akuzuar se ka njoftuar median në këtë takim. Në këtë kontekst, ankuesi sqaron se kur ka dhënë intervista në media gjatë periudhës 2019-2021, nuk është thirrur asnjëherë nga drejtuesit e universitetit, ndërsa në datën 15.10.2021, sapo ka reaguar MAS, ai është njoftuar për takim urgjent me Rektoren.

Lidhur me pretendimin për diskriminim nga z. R.D, Kryetar i Këshillit të Etikës, ankuesi citon, si vijon:

1. Nuk ka trajtuar çështjen mbi ankimin e studentes E.V., në bazë të Kodit të Procedurave Administrative, duke shmangur thirrjen e dëshmitarëve dhe paraqitjen e provave plotësuese nga ana e z. S;
2. Nuk ka zbatuar të drejtën për t'u dëgjuar dhe të drejtën për të thirrur dëshmitarë në procesin e hetimit pranë Këshillit të Etikës;
3. Nuk ka dalë me një vendim përfundimtar, duke cënuar dispozitat e Kodit të Etikës dhe Kodin e Procedurave Administrative;
4. Nuk ka zbatuar Kodin e Etikës, duke mos trajtuar asnjë nga tre ankesat që z. S ka depozituar. Ankuesi sqaron se në seancën e vetme të zhvilluar nga Këshilli i Etikës, Kryetari i këtij Këshilli ka deklaruar se nga ankuesja nuk është dorëzuar asnjë provë.

Lidhur me pretendimin për diskriminim nga znj. V.Z, me detyrë Drejtore e Drejtorisë Juridike në Rektorat, ankuesi citon, si vijon:

1. Nuk ka shqyrtuar siç duhet ligjshmërinë e kërkesës së studentes, duke anashkaluar Këshillin e Etikës, i cili është organi i vetëm ligjor që mund të marrë vendimin për shpalljen e konfliktit të interesit. Në këtë mënyrë, me shkresën e miratuar dhe dërguar si kthim përgjigje në Fakultetin Ekonomik, ka krijuar situatë diskriminuese dhe paragjyquese ndaj tij, duke tentuar të influencojë Këshillin e Etikës;
2. Rasti i sipërcituar është i përsëritur, pasi znj. Z ka kryer të njëjtat veprime, pas ankesës së z. S që është depozituar në Senatin Akademik në vitin 2020, pas miratimit të vendimeve të KMD-së.

Lidhur me pretendimin për diskriminim nga znj. E.Sh, me detyrë Administratore pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, ankuesi citon, si vijon:

1. Nuk ka miratuar hapjen e kamerave sipas legjislacionit në fuqi dhe nuk ka bërë asnjë veprim për rikthimin e ligjshmërisë kundrejt pengimit të hapjes së tyre nga Rektorja e këtij universiteti;
2. Nuk ka kthyer përgjigje mbi kërkesat që ankuesi ka dërguar në adresë të saj, sipas legjislacionit në fuqi;

Për sa më sipër, ankuesi kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të merren masat e mëposhtëme:

- Konstatimin e diskriminimit për shkak të veprimeve të paligjshme të Rektores së Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër;
- Konstatimin e diskriminimit të tij nga Këshilli i Etikës si pasojë e mostrajtimin të ankesave që ai ka depozituar ndaj studentes E.V., si dhe për mosdhënien e informacionit të detyrueshëm ligjor;
- Konstatimin e diskriminimit të tij nga Këshilli i Etikës si pasojë e mosdhënies së një vendimi përfundimtar për ankesën e studentes E.V. Ky Këshill ka mbyllur procedimin, duke refuzuar dorëzimin e provave shtesë dhe është shprehur me vendim pushimi, në kundërshtim të hapur me rregulloren e miratuar nga Senati Akademik dhe nga Kodi i Procedurave Administrative;
- Kërkimin e faljes publike nga subjektet e sipërcituara, duke pranuar gabimin e kryer ndaj tij, që ka sjellë si pasojë dëm në imazhin e tij, si dhe të informohen studentët dhe publiku për ngjarjen e ndodhur;
- Pushimin e cënimit në vendin e punës ndaj tij dhe kolegëve të Fakultetit Ekonomik;

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Ankesa objekt shqyrtimi fillimisht është regjistruar pranë Komisionerit me nr. 17 regj, datë 24.01.2022. Me vendimin nr. 42, datë 28.02.2022, Komisioneri ka vendosur: *“Mospranimin e ankesës nr. 17, datë 24.01.2022, së z. P.S, pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit nr. 10*

221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.”. Ankuesi ka kundërshtuar vendimin për mospranimin e ankesës pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila me vendimin nr. 2145, datë 20.07.2022, ka vendosur: “Pranimin e kërkesë padisë së paditësit P.S. Shfuqizimin e aktit administrativ vendim nr. 42, datë 28.02.2022 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Detyrimin e palës së paditur Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të marrë në shqyrtim në themel ankesën e paditësit P.S, në kuadër të një procedimi të rregullt administrativ dhe të dalë me aktin përkatës.” Në këtë vendim gjykata ka arsyetuar se: “...pala e paditur në kuadër të një hetimi të plotë dhe objektiv, duhet të administronte të gjithë praktikën e Komisionit të Etikës në lidhje me trajtimin e rastit, kjo në kushtet kur: 1. Situata e krijuar mes paditësit dhe studentes ka bërë që të dy t’i drejtohen Këshillit të Etikës me ankesë, duke kërkuar secili që këshilli të zhvillojë procedim disiplinor dhe të dalë me akt për marrjen e masës disiplinore; 2. Nuk provohet se çfarë është bërë me ankesat e paditësit ndaj studentes (gjithsej 3 ankesa); 3. Paditësi ka kërkuar informacion dhe nuk i është dhënë. ....Fakti që Komisioni i Etikës ka pushuar hetimin disiplinor ndaj paditësit, duke arsyetuar, ndër të tjera, se pretendimet e studentes nuk janë provuar, kjo nuk e përjashton Këshillin e Etikës nga detyrimi që ka për të zhvilluar procedim dhe për të dalë me akt mbi ankesat e paditësit ndaj studentes. Interesi i paditësit nuk çenohet vetëm nga vendimarrja e Këshillit në lidhje me ankesën e studentes ndaj tij, por dhe mosveprimi i Këshillit në lidhje me ankesat e paraqitura prej tij ndaj studentes, për sa kohë që ai pretendon se sjellja e kësaj të fundit ka qenë joetike dhe me ndikim në reputacionin e tij. Mosdhënia nga personi i tretë i informacionit dhe dokumentacionit se çfarë është bërë me këto ankesa, nuk mund të shërbente si argument nga Komisioneri për të dalë në konkluzionin se mosdhënia e informacionit hyn në fushën e veprimit të ligjit për të drejtën e informimit...Marrja e këtij informacioni dhe dokumentacioni nga personi i tretë në kuadër të një hetimi të thelluar administrativ do t’i shërbente palës së paditur për të dalë në konkluzionin në lidhje me pretendimet e paditësit se trajtimi nga këshilli vetëm i ankesës së studentes ndaj tij dhe jo i ankesës së tij ndaj studentes është një formë diskriminimi nga Këshilli i Etikës dhe strukturat e tjera të Universitetit, që janë përfshirë në këtë procedurë. Nga ankesa dhe provat e paraqitura, shkresat dhe komunikimet me e-mail, paditësi ngre pretendime se i janë mohuar të drejta bazë të një procesi të rregullt ligjor, siç është ajo për tu njohur me faktet, provat, për t’u dëgjuar dhe mbrojtur. I njëjti argument vlen dhe për shkaqet e tjera diskriminuese të pretenduara nga paditësi të parashtruara në ankesë në lidhje me përjashtimin nga komisionet apo qëndrimet e mbajtura nga strukturat e universitetit në lidhje me mendimet e veprimet e paditësit në vijim gjatë punës dhe për shkak të saj”.

Në zbatim të vendimit nr. 2145, datë 20.07.2022 Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e paraqitur nga ankuesi P.S, e cila u regjistrua me nr. 143, datë 20.09.2022, duke administruar të gjithë dokumentacionin dhe komunikimet e ankuesit.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Bazuar në nenin 7, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e punësimit, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të kapitullit II, të LMD. Në nenin 12, pika 1, germa “c” të LMD, parashikohet: “1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ..... c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;”

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë dhe duke marrë në shqyrtim vetëm ato çështje që hyjnë në kompetencat e institucionit.

1. Me shkresën nr. 1268/1 prot., datë 21.09.2022, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga subjektet kundër të cilëve është paraqitur ankesa. Në vijim të kësaj kërke, subjektet kundër të cilëve është paraqitur ankesa kanë kthyer përgjigje si më poshtë:

1.1 Me shkresën nr. 2005/8 prot., datë 30.09.2022, znj. S.G, Rektore e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” (në vijim USHLG) ktheu përgjigje duke parashtruar: “Në përgjigje të shkresës tuaj nr.1268/1 prot., datë 30.09.2022, e administruar në Rektorat me nr. 2005/6 prot., datë 23.09.2022, po ju dërgojmë dokumentacionin e kërkuar nga Ju, në lidhje me rastin e pedagogut P.S. Sqaroj se inicimi i çështjes në Këshillin e Etikës është bërë nga vetë studentja E.V. me shkresë nr. 2317 prot., datë 26.07.2021 dhe jo nga ana ime si Rektore e Universitetit”.

1.2 Me shkresën nr. 2005/9 prot., datë 05.10.2022, Këshilli i Etikës, me Kryetar R.D dhe anëtarë znj. Ermira Alija dhe znj. Nora Deda, ktheu përgjigje duke parashtruar: “Këshilli i Etikës (KE) me datë 27.09.2022 ka zhvilluar një mbledhje me objekt kthim përgjigje shkresës numër 1268/1 prot., datë 21.09.2022, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD). Në përgjigje të kërkesës për informacion të KMD-së, KE informon sa më poshtë: T’i dërgohet KMD-së “Vendimi për pushimin e hetimit administrativ ndaj pedagogut për masë disiplinore ndaj z. P.S”; Gjithashtu KE deklaroi se anjë nga anëtarët e KE nuk ka qenë në konflikt interesi në ankesën ku është pjesë P.S. T’i dërgohet dosja e dokumentacionit që ka shqyrtuar KE ndaj studentes E.V. Të gjitha e-maillet e dërguara të korrespondencës së KE dhe P.St. KE ka marrë një ankesë nga P.S ndaj studentes E.V.

*ku ka vlerësuar se nuk ekzistojnë kushtet për të regjistruar fillimin e hetimit për masë disiplinore ndaj E.V. duke vlerësuar apo çmuar edhe faktin se studentja është ç' regjistruar nga USH. ”*

1.3 Me shkresën nr. 2005/7 prot., datë 26.09.2022, znj. V.Z, Drejtore e Drejtorisë Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës, ktheu përgjigje duke parashtruar: *“...Me datën 21.08.2021, Dekania e Fakultetit Ekonomik ka përcjellë në Rektorat kërkesën me nr. 872 prot., datë 31.08.2021, administruar në Rektorat me nr. 2565 prot., datë 31.08.2021, me anë të së cilës i kërkonte Rektores “Interpretim juridik të kërkesës së studentes E. V. në lidhje me ligjin për konfliktin e interesit, meqënëse rregullorja e studimeve nuk parashikon rregullime të rasteve të tilla”. Kjo kërkesë, e cila i drejtohej Rektorit është kaluar për trajtim nga Sektori Juridik, i cili ka dhënë opinionin juridik tërësisht objektiv dhe të paanshëm, sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me rregulloren për konfliktin e interesit të USH-së. Dhënia e opinionëve juridike, si në rastin konkret është pjesë e detyrave funksionale të Sektorit Juridik në USH. Ndërsa për pretendimet e vitit 2020 është po e njëjta situatë ku z. S hedh akuza në emrin tim, në lidhje me një “kthim përgjigje” të hartuar nga ish Rektori i kohës Prof. Dr. A.B. Sqaroj se nuk kam hartuar asnjë përgjigje për z. S, shkresa nuk është hartuar nga sektori juridik. Së fundmi por jo nga rëndësia e ndodhur në një situatë përsëritëse nga z. S ndihem e diskriminuar nga fakti që gjatë realizimit të detyrave funksionale dhe leximit të ligjit atakohet në mënyrë direkte emri im si drejtor drejtorie, pa asnjë provë apo bazë ligjore. Struktura juridike nuk është organ vendimmarrës në USH, si dhe nuk është organ epror për z. S. Çka hedh poshtë çdo pretendim të z. S për diskriminim, leximi i ligjit në mënyrë të paanshme pavarësisht statusit që gëzojnë palët është detyrim ligjor.”*

1.4 Me e-mail datë 31.10.2022, ankuesi ka depozituar prapësimet e tij në lidhje me shkresat e mësipërme të depozituara nga subjektet kundër të cilëve është paraqitur ankesa, duke parashtruar:

- Rektorja nuk është shprehur nëse ka qenë ose jo në konflikt interesi. Rektorja deklaron se nuk ka ndërhyrë në KE, por nuk shpjegon se cili është shkaku që ka kërkuar ndërrim komisionesh dhe hapjen e 3 datave të provimit. Rektorja nuk ka paraqitur procesverbalet e mbledhjeve me dekanet, ku të vërehet se çfarë ka deklaruar kundër ankuesit. Ankuesi shpjegon se vitin e kaluar asnjë koleg nuk ka pranuar që të punojë me të për shkak të këtij konflikti, i cili ka përkeqësuar punën e tij akademike. Ankuesi thekson se nuk ka nevojë për vërejtje të shkruar sepse ai duhet të marrë titullin profesor në të ardhmen dhe kjo duhet të pranohet nga këto profesora dhe një rast i tillë i shpikur nga rektorja mund të influencojë. Vetëm pasi është shpallur i pafajshëm në shtator është bërë pjesë e një grupi pune për projekte të BE dhe e kanë fituar. Nuk është kthyer asnjë përgjigje në lidhje me ankesën e bërë nga ana e tij. Rektorja dhe etika nuk e kanë përcjellë ankesën e tij sikurse kanë bërë me ankesën e studentes që është dërguar me e-mail. Për takimin e dytë, ku ankuesi pretendon se i është kërkuar dorëheqja nga mandati si përfaqësues i asamblesë, nuk është depozituar asnjë dokumentacion.
- Në dosjen e dërguar nga etika/juristja/rektorja janë hequr disa dokumente për të favorizuar ankuesen, si vijon: - procesverbali i fakultetit ekonomik për ngjarjen ku vërehet se nuk ka patur asnjë ngjarje të supozuar nga studentja; procesverbali i deklaratave të studentes, të shefes së departamentit dhe deklarata e ankuesit në KE. Sipas ankuesit nuk janë dërguar edhe mesazhet sms të depozituara prej tij ditën e takimit me KE ku vërehet sjellja e studentes për të ushtruar ndikim për kalimin e provimit. Është dërguar një shkresë nga juristja V.Z nga e cila vërehen ndryshime nga shkresa e protokolluar në fakultetin ekonomik dhe dërguar me e-mail zyrtar, ku

janë shënuar emrat e ideatorit dhe konceptuesit të shkresës për të shmangur nga përgjegjësitë në zyrën juridike për shmangien e procedurave të miratuara nga senati akademik për rregulloren e provimeve dhe konfliktin e interesit. Rastet janë të përsëritura dhe për shkak të asaj shkrese edhe znj. Z ka keqinterpretuar rregulloret e universitetit vetëm për të më penalizuar. Gjithashtu, studentja ka deklaruar në etikë se ka edhe 5 denoncime ngaj meje në polici sepse ja ka thënë shefi i policisë. Për këtë gjë është pyetur nga KE. Në shkresat e dorëzuara nuk del në asnjë pikë deklarimi i studentes, mungojnë procesverbalet.

- KE për të evituar shkeljen ka bërë deklarim të rremë duke thënë se ka vendosur që të mos e hapë çështjen ndaj studentes sepse është çregjistruar nga universiteti. Ankuesi shpjegon se ka qenë në sekretari kur studentja ka shkuar për të kryer veprimet dhe ka qenë data 18.10.2021. Kur janë pyetur në prokurori anëtarët e KE kanë deklaruar se vendimin ia kanë dërguar rektores për miratim (deklaratë me gojë e anëtares E.A) ndërsa anëtarja B.L. ka deklaruar se çështja është pushuar dhe jo përfundimtare. Pra sipas saj, ai ende nuk ishte shpallur i pafajshëm.
- Nuk janë administruar kamerat sipas kërkesës së tij, për të vërtetuar ndërhyrjet e motrës së E.V. në ambientet e universitetit sepse ajo është shoqe e ngushtë me anëtares e KE. Kamerat e vetme janë ato që ka sekuestruar policia pas ankesës që ankuesi ka paraqitur në polici sepse po plotësohej afati 2 mujor dhe rrezikohej fshirja e tyre. Ato kanë sekuestruar vetëm pjesën e ankesës objekt denoncimi por nuk janë marrë me atë që ankuesi ka paraqitur si ankesë në KE për të vërtetuar se motra e studentes ka qenë në ambientet e provimit me datë 13.07.2021 duke tentuar që të ndërhynte në provime.
- Në takimin me KE me datë 02.09.2022 ankuesi pretendon shpjegon se ka informuar anëtares B.L. për një konflikt tjetër interesi. Për këtë arsye duhet të depozitohet procesverbali i marrjes në pyetje për të verifikuar një gjë të tillë.
- Ankuesi shprehet se, me shkresën e datës 07.09.2022 ka informuar për procesin gjyqësor dhe se ai do të depozitonte dokumentacionin nga gjykata, por procesi është ndërprerë pa e marrë transkriptin, pasi gjykata ka vonuar në dorëzimin e CD me regjistrimin e gjyqit. Më datë 04.10.2022, ankuesi ka kërkuar informacion zyrtar të cilin ia kanë dhënë vetëm pjesërisht vetëm pas ankesës tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit. Më datë 05.10.2022 ka kërkuar përsëri që të merren masa ndaj studentes si dhe nëse janë në konflikt interesi të tërhiqen. Nga dokumentacioni i dorëzuar vërehet se janë hequr dokumentat e dorëzuara nga fakulteti ekonomik për ngjarjen dhe është dorëzuar denoncimi i pafirmosur.

2. Bazuar në nenin 33, pika 8, të LMD, ku parashikohet se: *“8. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”*, për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, me shkresën nr. 1268/5 prot, datë 23.11.2022, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e një seance dëgjimore në datën 20.12.2022, e cila nuk u zhvillua, për shkak të mosprezencës së subjekteve kundër të cilëve drejtohet ankesa.

3. Me shkresën nr. 2005/11 prot datë 02.12.2022, znj. S.G, Rektore e Uiversitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, sqaron se ndaj vendimit nr.2145, datë 20.07.2022, të Gjykatës

Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ka depozituar ankim Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Tiranë.

4. Me shkresën nr.1268/7 prot., datë 23.12.2022, Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 18.01.2023.

Seanca dëgjimore e datës 18.01.2023, u zhvillua me pjesmarrjen e ankuesit P.S, i cili u paraqit personalisht prezent. Në seancë nuk morën pjesë asnjë prej subjekteve kundër të cilëve është paraqitur ankesa. Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi i qëndroi të njëjtave parashtrime sikurse kishte paraqitur në ankesë.

5. Me *e-mail* datë 24.01.2023, ankuesi depozitoi sqarime shtesë në lidhje me shkaqet e pretenduara të diskriminimit, duke parashtruar : *“Në procesin gjyqësor që studentja ka zhvilluar ndaj meje me datë 04.09 ka deklaruar se ajo është favorizuar nga të gjithë pedagogët (edhe nga strukturat drejtuese) dhe se unë nuk e kam bërë një gjë të tillë. Sipas ankesës së studentes unë duhej të bëja një test më të thjeshtë duke marrë për bazë karakteristikat e studentes. Pra, ankesa e studentes ishte ndaj meje për shkak të karakteristikave që unë posedoj dhe nuk toleroj favorizime të cilat duhet të ishin bërë në rastin e saj. ....Për këtë arsye kërkoj që kjo të pranohet te shkaqet e diskriminimit që kam cituar si pjesë e programit Brain Gain në të cilën kam cituar se nuk pranoj ndërhyrje për provime dhe favorizime në kundërshtim me ligjin”.*

6. Me *e-mail* datë 31.01.2023, ankuesi ka parashtruar se, ankesa është e bazuar në dokumentat e dërguara nga KE, organ i cili po ndryshon dokumentat me qëllim lehtësimin e pozitës së personave të përfshirë dhe ka shkelur në mënyrë flagrante të drejtat e tij duke mos i dhënë asnjë informacion sipas ligjit (ka dorëzuar një pjesë të dokumentacionit 7 muaj nga hapja e çështjes dhe regjistrimet e kamerave vetëm me kërkesën e KMD).

7. Me shkresën nr. 337 prot., datë 02.03.2023, Komisioneri iu drejtua subjekteve znj. S.G, Rektore e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe z. R.D, Kryetar i Këshillit të Etikës, pranë këtij universiteti, me një kërkesë për informacionin i cili pavarësisht kërkesave të mëparshme të Komisionerit, nuk janë depozituar nga ana e këtyre subjekteve apo të jenë dhënë shpjegime në lidhje me pamundësinë e depozitimit të akteve të kërkuara. Në vijim të kërkesës së mësipërme për informacion, subjektet kanë dërguar përgjigjet e mëposhtme:

- 7.1 Me shkresën nr. 800/1 prot., datë 08.03.2023, znj. S.G, Rektore e USHLG, ka kthyer përgjigje duke parashtruar:

Në lidhje me mbledhjen e Rektoratit të datës 14.09.2021 dhe 15.10.2021, ju bëjmë me dije se diskutimet e këtyre mbledhjeve nuk kanë lidhje me rastin në fjalë.

Studentja E.V. është çregjistruar nga Universiteti i Shkodrës më datë 19.10.2021.

Ndaj pedagogut P.S nuk është marrë dhe nuk ka asnjë masë disiplinore në fuqi, sipas dosjes personale që disponohet në Rektorat.

7.2 Me shkresën nr. 800/2 prot., datë 09.03.2023, Këshilli i Etikës, me Kryetar R.D dhe anëtarë znj. E.A, znj. K. L dhe znj. B.L, ka kthyer përgjigje duke parashtruar:

Këshilli i Etikës (KE) ndaj zotit S në asnjë rast nuk ka vepruar apo mosvepruar duke e diskriminuar atë. KE ka trajtuar dy raste ku ka qenë i përfshirë z. S.

Çështjet të cilave i referohet z. S, janë trajtuar në tetor të vitit 2021 nga KE; në fakt janë dy kërkesa; njëra e bërë nga një studente ndaj z. S dhe pas kësaj ka patur një kërkesë të z. S për të marrë masë disiplinore ndaj studentes. Gjatë shqyrtimit të çështjes ndaj z. S, KE nuk ka gjetur prova të mjaftueshme për të provuar pretendimet e subjektit ankues dhe ka dalë me vendimin për ta pushuar çështjen. Gjatë shqyrtimit të kësaj çështje, z. S ka patur mundësi për të provuar paanshmërinë e KE dhe mungesën e çdo lloj tendence negative apo diskriminimi ndaj tij. Në asnjë moment z. S nuk ka patur pretendime dhe as ankesa ndaj KE gjatë shqyrtimit të çështjes. Theksojmë se, palët kanë hapur procese gjyqësore ndaj njëra tjetres gjatë kohës që KE po trajtonte ankesën e studentes ndaj z. S. KE është thirrur dhe paraqitur për të dëshmuar në Prokuori për këtë çështje. Pas kësaj çështje z. S ka kërkuar marjen e masës disiplinore “Pezullim për 1 vit për studenten, për shkelje të Kodit të Etikës” në një kohë që çështja po trajtohej edhe në gjykatë. KE nuk ka hapur një hetim për këtë ankesë, sepse studentja u çregjistrua nga USH dhe nuk ishte më subjekt i Kodit të Etikës. Theksojmë se KE gjatë shqyrtimit të ankesave, ku z. S ka qenë subjekt, nuk ka pranuar të administrojë regjistrime audio/video apo sms të bëra nga vetë ai ndaj personave të tjerë. Në asnjë rast nuk ka patur ankesë nga z. S për konflikt interesi të anëtarëve të KE. Pamjet filmike janë përdorur për dëshmi nga KE.

KE nuk është organ që funksionon me kohë të plotë. Të gjithë anëtarët e KE nuk kanë asnjë reduktim të impenjimeve të tyre për shkak të të qënurit anëtarë të KE.

Nisur nga fakti se z. S nuk i është krijuar asnjë pasojë nga veprimet e KE, besojmë se të gjitha pretendimet e tij për diskriminim janë të paqena.

7.3 Me anë të *e-mailit* datë 21.03.2023, Këshilli i Etikës, nëpërmjet znj. E.A, Sekretare e KE, depozitoi procesverbalet e mbledhjeve të KE gjatë pyetjes së studentes E.V, z. P.S dhe znj. E.B, Shefe e Departamentit.

8. Nëpërmjet disa *e-maileve* dhe konkretisht, në datë 25.03.2023, 07.04.2023 dhe datë 13.04.2023, ankuesi ka parashtruar, në mënyrë të përsëritur ankesën për mosdhënien e dokumentacionin dhe procesverbaleve të mbledhjeve nga Rektori dhe KE dhe se vazhdon fshehja e dokumentacionit nga ana e këtyre subjekteve, duke shkelur ligjin. Mënyra e veprimit nga organi kolegjal i KE dhe nga rektorja nëpërmjet fshehjes së dokumentacionit, sipas z. S, tregon se ka një prapavijë të qartë për ta penalizuar dhe diskretituar para kolektivit. Ankuesi parashtron se, deklarata se nuk ka pasur prova ose se studentja është çregjistruar nuk qëndron dhe është mashtrim sepse shkresa e dërguar nga fakulteti ekonomik dhe sms që studentja ka dërguar nuk ndodhen në dosje. Ajo janë hequr nga dosja me qëllim për ta penalizuar dhe për të favorizuar ankuesen.



Në fakt hera e parë që KE ka pyetur sekretarinë mësimore në fakultetin ekonomik për çregjistrimin e studentes ka qenë muaji dhjetor 2022, fakt ky që del nga shkresa nr.800/1 prot., datë 08.03.2023 e dërguar nga rektorja. KE nuk ka marrë asnjëherë asnjë informacion zyrtar pranë fakultetit deri në momentin kur është shprehur gjykata dhe kanë filluar shkresat e KMD. Studentes i kanë dërguar vendimin për ankesën që ajo kishte bërë, ndërsa në rastin e 3 ankesave të tij nuk ka marrë asnjë vendim zyrtar për mospranimin e ankesave. Për hapjen e dosjes ndaj tij KE ka shkelur rëndë ligjin duke administruar dokumenta të cilat përbëjnë sekret hetimor dhe vetëm prokuroria dhe gjykata mund t'i vlerësojnë.

Arsyetime i rektores së procesverbalet e mbledhjeve nuk janë pjesë e çështjes nuk janë të vërteta sepse në takimin e datës 14.09.2021 kanë qenë edhe 3 persona të tjerë përveç rektores (zv. rektore, dekane e FE dhe shefja e departamentit). Ankesa nuk është vetëm për KE por është edhe ndaj veprimeve të rektoratit në mbledhjen e muajit tetor 2021 në të cilën ka kërkuar dorëheqjen e tyre nga detyrat për shkak se fakulteti kishte votuar kundër rektores. Në këtë takim kanë qenë edhe 15 kolegë të tjerë.

Në lidhje me dokumentacionin e dërguar nga KE për deklaratat e bëra para këtij këshilli nga studentja, ankuesi dhe shefja e departamentit, ankuesi parashtron se dokumenti i dërguar nuk është procesverbali i mbledhjes por një transkript i bërë nga KE, pa datë, në të cilin KE ka modifikuar deklaratat e mbledhjeve duke tentuar që të modifikojë procesin para KMD. Sipas ankuesit, transkripti nuk reflekton procesverbalet dhe është modifikuar për të influencuar hetimin e KMD. Duke pretenduar se deklaratat që ai ka bërë para KE janë manipuluar disa pika duke mos u paraqitur siç janë deklaruar nga ana e tij, nëpërmjet e-mailit të datës 13.04.2023, i cili është administruar në dosje, ankuesi ka pasqyruar momentet që sipas tij janë manipuluar në dokumentin e depozituar nga KE.

9. Nëpërmjet *e-maileve* datë 02.05.2023 dhe 04.05.2023, ankuesi thekson se pas vendimit të gjykatës për të mos u penalizuar nga KMD, kryetari i KE, ka dhënë deklaratat të ndryshme para KMD nga ato që ka dhënë para organit të prokurorisë.

10. Nëpërmjet një tjetër *e-maili* datë 04.05.2023, ankuesi pretendon se, pas hapjes së procedimit nga KMD, veprimet e z. D, e kanë penalizuar dhe sjellja e tij vazhdon të prodhojë efekte diskriminuese. Në lidhje me këtë moment ankuesi parashtron se, në një shkresë që z. D ka dërguar në muajin janar, si pasojë e ankesës që ai kishte paraqitur në Senatit Akademik ndaj veprimeve arbitrare në krye të KE, vërehen deklaratat komplet ndryshe nga ato të administruara në dosjen e prokurorisë.

11. Nëpërmjet dy *e-maileve* të datës 10.05.2023, ankuesi ka parashtruar se, në kërkesën e dytë që ka bërë për shkarkimin e anëtarëve të KE, ka marrë një përgjigje nga anëtarja B.L, ku ajo pranon se ka patur lidhje shoqërore me motrën e studentes, kjo në kundërshtim me shkresën e dërguar në KE. Motra e studentes ka qenë pjesë e ankesës që ankuesi ka dërguar në KE dhe në një pikë ka qenë kërkesa për të administruar kamerat për të vërtetuar se motra ka ardhur në fakultet në orarin e provimit dhe i ka dalë para edhe pas provimit. Ankuesi pretendon se ky *e-mail* përveç faktit që është ofendues dhe kërcënues, përmban deklaratat të znj. L, të cilat sipas tij nuk janë të vërteta.

Sipas tij deklarata e znj. L se: “*Ju keni pirë kafe me studenten*”, është e pavërtetë dhe janë pjesë e veprimeve të ndërmarra nga ana e saj dhe e anëtarëve të tjerë të etikës për të shpifur dhe për t’u ulur ankuesin para kolektivit. Në asnjë moment studentja nuk e ka deklaruar një gjë të tillë. Për këtë arsye, ankuesi kërkon konstatimin e diskriminimit dhe kërkon nga Komisioneri që të detyrojë institucionin për të përgënjeshtuar lajmin.

12. Nëpërmjet *e-mailit* datë 18.05.2023, ankuesi, parashtron në vijim se, trajtimi që KE ka bërë ndaj tij është ndryshe nga ato që ka bërë me 3 çështjet e tjera që janë trajtuar në KE, ku ka dalë me vendim përfundimtar menjëherë duke i dhënë të drejtën që të shkojnë në gjykatë. Sipas ankuesit, në rastin e tij, në fillim ka thënë është vendim përfundimtar (por ka fshehur dokumentacionin për 7 muaj) pastaj ka ndërruar duke thënë është vendim pushimi (i cili nuk ekziston në Kodin e Procedurave Administrative dhe Civile) vetëm për të shpëtuar nga situata. KE më ka trajtuar në mënyrë komplet diskriminuese ndaj personave të tjerë që janë trajtuar nga ky këshill dhe kjo ka ardhur për shkak të kushteve të mbrojtura nga ligji i diskriminimit.

KE nuk ka treguar asnjë dokumentacion që të vërtetojë se cilat janë arsyet pse nuk ka filluar asnjë hetim administrativ ndaj studentes për sjelljen e saj në kundërshtim me rregulloren e miratuar të Etikës.

13. Nëpërmjet *e-mailit* datë 23.05.2023, ankuesi ka depozituar vërtetimin nr. 1813 prot, datë 19.05.2023, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, sipas të cilit vërtetohet se ndaj ankuesit nuk rezulton të ketë procedim penal në hetim, të regjistruar në ngarkim të tij nga viti 2013 deri më sot.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.**

Bazuar në parashtrimet, kronologjinë e ngjarjeve dhe dokumentacionin e administruar gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vëren se:

Ankuesi P.S, është i punësuar si pedagog pranë Fakultetit Ekonomik, të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, ku punon që prej vitit 2008. Ai i është drejtuar Komisionerit me një ankesë, duke pretenduar se është diskriminuar nga subjektet kundër të cilëve ka paraqitur ankesën, lidhur me disa ngjarje që kanë ndodhur në USHLG, që ka të bëjë me ankesën e një studenteje, që sipas ankuesit ka qenë një ngjarje e stisur.

Rezultoi se, në datën 15.07.2021, studentja e masterit profesional E.V. është paraqitur pranë zyrës së ankuesit dhe ka kërkuar informacion për notën që kishte marrë në lëndën e Menaxhimit Bankar. Në prani të Përgjegjëses së departamentit, ankuesi i ka lexuar studentes vlerësimin jokalues. Gjatë dhënies së rezultatit studentja ka patur pakënaqësi nga vlerësimi që ka marrë në këtë lëndë. Situata është tensionuar dhe në vijim është njoftuar policia e shtetit.

Po në të njëjtën ditë, në lidhje me ngjarjen e ndodhur, Përgjegjësja e departamentit znj. E.B, e cila ishte prezent gjatë situatës së krijuar midis ankuesit dhe studentes E.V., ka hartuar procesverbalin me nr.781 prot., datë 15.07.2021, drejtuar Dekanes së Fakultetit Ekonomik. Në këtë procesverbal shefja e departamentit znj. E.B, deklaron ndër të tjera se: *“...Sapo studentja është njoftuar për pikët e akumuluar në testin 100 pikësh ka reagu duke qarë e ulëritur për të marrë notë pozitive. Duke qenë se studentja pretendonte për test të diferencuar nga pjesa tjetër e klasës, në praninë time, të pedagogut në fjalë dhe të studentes, është bërë verifikimi i pyetjeve të testit duke konstatuar se është i njëjti test i dhënë tërë studentëve, por testi i saj është 100 pikësh sepse studentja në fjalë është stazhiere. Sapo studentja ka filluar të citojë problematika që nuk kishin lidhje me verifikimin e testit (të tipit duke përmendur testet e mëparshme, familjarë të profesorit etj), profesori e ka konsideruar të panevojshëm për të vazhduar komunikimin me studenten, sepse nuk flitej më për pyetjet e testit dhe pretendimet e studentes nuk lidheshin me testin, ka mbyllur derën duke na lënë jashtë në korridor mua dhe studenten E.V... Ju vë në dijeni gjithashtu që asnjë kërkesë-ankesë nga ana e studentes, në fjalë nuk ka ardhur për rikorigjimin e provimit të lëndës “Menaxhim Bankar”. Nën këto kushte, profesori ka telefonuar sallën operative dhe sapo studentja ka marrë vesh që është njoftuar policia, ka njoftuar policinë për të njëjtën ngjarje. Vazhdimi i incidentit është referuar më tej në organet kompetente.”*

Në datë 15.07.2021, ankuesi i është drejtuar me anë të një e-maili rektores znj. S.G, duke e informuar në lidhje me ngjarjen e ndodhur në fakultet me studenten E.V dhe duke kërkuar që të veprohej menjëherë nga ana e universitetit për të verifikuar ngjarjen nëpërmjet kamerave të institucionit dhe për të zbardhur ngjarjen që sipas ankuesit mund të cënonte imazhin dhe familjen e tij. Të nesërmen, në datë 16.07.2021, ankuesi ka paraqitur me e-mail, kërkesën për një kopje të kamerave të godinës së fakultetit të datave 15.07.2021 dhe datë 13.07.2021, me arsyetimin se kishte bërë denoncim penal në policinë e Shkodrës. Kërkesa i është drejtuar rektores znj. S.G dhe administratores znj. E.Sh.

Në datën 19.07.2021, studentja E.V. ka dërguar me e-mail në adresën e rektores znj. S.G dhe kryetarit të KE z. R.D, një kërkesë për mbledhjen e KE të USHLG për të trajtuar ngjarjen e ndodhur në datën 15.07.2021, duke pretenduar: shkeljen e procedurave në komunikimin administrativ mbi të drejtën e informacionit mbi rezultatet e provimit; vlerësimin e qëllimshëm si negativ të rezultatit të provimeve me këtë profesor; shkeljen e Kodit të Etikës nga pedagogu P.S, në përdorim të dhunës psikologjike dhe fizike ndaj saj dhe cënim të imazhit publik, duke i përplasur derën e zyrës dhe duke i shkaktuar dëmtime psikologjike dhe fizike; si dhe mungesën e reagimit administrativ nga menaxhmenti i Fakultetit Ekonomik, për të komunikuar ngjarjen, pranë KE dhe Rektoratit të Universitetit. Studentja informon se ka bërë kallëzim në polici dhe prokurori.

Në datën 23.07.2021, ankuesi i është drejtuar dekanes së fakultetit ekonomik dhe Përgjegjëses së departamentit, me një kërkesë me shkrim (protokolluar me nr.799) për t'u dorëhequr nga komisioni i provimit për lëndën e modelimit financiar në masterin profesional financë bankë (korrigjim dhe firmosje e procesverbaleve), për shkak se mendonte se ishte në konflikt interesi me studenten E.V,

si pasojë e denoncimit që kishte bërë në prokurori kundër saj. Këtë kërkesë ankuesi e kishte paraqitur edhe nëpërmjet *e-mailit* në datë 21.07.2021.

Në datën 24.07.2021, ankuesi ka dërguar me *e-mail* në adresën e rektores së universitetit znj. S.G, një kërkesë/ankesë për referimin e veprimeve të studentes E.V. për veprime të mëtejshme nga Këshilli i Etikës. Ankuesi thekson se, për shkak se ngjarja e ndodhur cënonte rëndë punën dhe imazhin e tij dhe të familjes së tij, do ta ndiqte çështjen në çdo shkallë të nevojshme.

Rezulton se në datën 27.08.2021, studentja E.V ka paraqitur një kërkesë për ndryshimin e komisionit në riprovimet e lëndës Menaxhim Bankar dhe Modelim Financiar, të cilën ia ka drejtuar rektores znj. S.G dhe dekanes së fakultetit ekonomik znj. B.D. Nëpërmjet kësaj kërkesë, studentja ka kërkuar ndryshimin e komisionit në riprovimet në muajin shtator e në vijim për 2021, pa pjesëmarrjen e ankuesit, pa pjesëmarrjen e profesorëve që kanë lidhje farefisnore me profesorin dhe të tjerë që kanë dhënë lëndën me të si dhe pa pjesëmarrjen e znj. E.B (Përgjegjëse e departamentit), e cila ka marrë pjesë direkte në ngjarje.

Në lidhje me kërkesën e studentes për ndryshimin e komisionit të riprovimit, Përgjegjësjë e departamentit znj. E. B., i është drejtuar dekanes së fakultetit ekonomik me një kërkesë për interpretim juridik të kërkesës së studentes, meqënëse rregullorja e studimeve e universitetit dhe fakultetit nuk parashikon trajtim të rasteve që bazohen në ligjin mbi konfliktin e interesit (shkresa nr. 871 prot., datë 31.08.2021). Me anë të shkresës nr. 872 prot., datë 31.08.2021 të dekanes së fakultetit ekonomik, kjo kërkesë e paraqitur nga Përgjegjësjë e departamentit, i është përcjellë për interpretim juridik rektores znj. S.G.

Me shkresën nr. 2565/1 prot., datë 02.09.2021, të rektores së universitetit znj. S.G, i është kthyer përgjigje kërkesës së përsipërme të parashtruar nga fakulteti ekonomik, duke sqaruar se, kërkesa e studentes ishte plotësisht e bazuar në ligj dhe se, dekani dhe përgjegjësi i departamentit sipas rastit të marrin të gjitha masat në zbatim të ligjit për të shmangur çdo rrethanë që krijon ose mund të krijojë gjendjen e konfliktit të interesit në gjykimin e vlerësimit ndaj studentes. Ankuesi pretendon se shkresa e rektores ishte paragjyquese dhe diskriminuese, sepse krijonte precedent të rëndë për studentë të tjerë jo kalues në të cilët ankuesi ishte lektor, sepse mund të adoptojnë të njëjtën strategji dhe të kërkojnë ndërrimin e komisionit të provimit, duke paraqitur një ankesë në KE. Ankuesi thekson se, shkresa e rektores e konsideron të drejtë kërkesën e studentes me pretendimin se ai ishte në konflikt interesi me studenten për shkak të një procesi gjyqësor, por deri në atë periudhë ankuesi thekson se ai nuk ka patur asnjë proces gjyqësor me studenten.

Ankuesi është njoftuar nëpërmjet një *e-maili* që mban datën 30.08.2023, për tu paraqitur pranë KE në datën 02.09.2021, kjo në kuadër të shqyrtimit të një ankese që ishte paraqitur në KE. *E-maili* nuk përmbante informacion në lidhje me ankesën që do të shqyrtohej dhe për të cilën ankuesi ishte thirrur të paraqitej para KE.

Në datën 02.09.2021, ankuesi është paraqitur pranë KE. Sipas njoftimit të realizuar nëpërmjet e-mailit të datës 30.08.2021 radha e paraqitjes para KE, ishte caktuar, në orën 10:00 studentja dhe në orën 11:00 do të paraqitej ankuesi. Gjatë dëgjësës përpara KE janë mbajtur procesverbalet e pyetjes së studentes, ankuesit dhe shefes së departamentit, por këto akte janë të nënshkruara vetëm nga anëtarët e KE dhe jo nga personat të cilët kanë deklaruar. Ankuesi gjatë shqyrtimit të ankesës prapësoi se aktet e dorëzuara nga KE nuk pasqyrojnë deklaratat që ai kishte bërë në KE por ishin modifikuar nga ky i fundit. Gjithashtu ankuesi pretendon se deri në momentin e paraqitjes para KE nuk ka patur informacion për ankesën e studentes kundër tij, por ka menduar që është thirrur për ankesën që kishte paraqitur kundër studentes, të cilën e kishte përcjellë me *e-mail* në adresën e *e-mailit* të rektores, ku ka sqaruar ngjarjen e ndodhur. Një fakt i tillë gjen pasqyrim edhe në procesverbalin e mbajtur gjatë dëgjësës së ankuesit në KE. Meqënëse anëtarët e KE nuk e kishin marrë ankesën e paraqitur nga ankuesi në datën 24.07.2021, ankuesi e ka përcjellë atë me *e-mail* datë 02.09.2021 tek anëtarët e KE.

Në mbrëmje, të njëjtën ditë me dëgjësën e zhvilluar para KE, ankuesi ka vënë re se anëtarja e KE znj. B.L ishte ulur në të njëjtën tavolinë (karrige lokali në park publik) me studenten dhe motrën e saj, të cilën ankuesi e kishte përmendur në mbledhjen e KE, duke pretenduar se kishte patur ndërhyrje për të kaluar studenten në provim, por pa emër pasi nuk kishte informacione deri në ato momente. Në këto momente ankuesi ka filluar të filmojë me telefonin e tij skenën për të dokumentuar ngjarjen me pretendimin se studentja po ndikonte tek anëtarët e KE që ishte duke shqyrtuar ankesën e studentes kundër tij.

Nga aktet e administruara rezulton se, në datën 04.09.2021, studentja është paraqitur në Komisaratin e Policisë Drejtoria Vendore Shkodër, për të denoncuar dhunën e ushtruar nga ana e ankuesit dhe është ndihmuar nga oficerët e policisë për të plotësuar kërkesë padinë për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, sipas ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “*Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*”, i ndryshuar. Me vendimin nr. 201, datë 05.09.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka vendosur refuzimin e lëshimit të Urdhrit të Menjëhershëm të Mbrojtjes, për mungesë legjitimitimi të palëve ndërgjyqëse. Gjatë gjykimit ka rezultuar se marrëdhënia midis palëve (studentes dhe ankuesit) nuk është lidhje fafëfisnore, familjare, krushqie, intime apo bashkëjetese. Gjykata ka arsyetuar se studentja nuk legjitomhet për të ngritur padi me objekt marrjen e masave ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare përkundrejt profesorit të saj, i cili gjithashtu nuk ka legjitimitim pasiv. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim z. S duke mos qenë dakort me shpenzimet gjyqësore dhe mosgjorbijten e studentes, si dhe kundër ankim studentja. Me vendimin nr. 198, datë 03.11.2021, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të dhenë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me disponimin se kundër vendimit nuk lejohet rekurs.

Nga aktet e administruara, rezulton gjithashtu se, më datë 04.09.2021, studentja ka bërë një kallëzim penal kundër ankuesit duke pretenduar se ky i fundit ka konsumuar elementë të veprës penale “përndjekja”, parashikuar nga neni 112/a i K.Penal. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në përfundim të veprimeve hetimore ka arritur në përfundimin se nuk provohet konsumimi i elementëve të veprës penale të “*Përndjekjes*”. Me vendimin nr. 991, datë 20.09.2022,

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe pushimin e çështjes penale lidhur me procedimin penal me nr. 1170, datë 01.10.2021, regjistruar për veprën penale të “Përndjekja” të parashikuar nga neni 112/a të K.Penal në ngarkim të shtetasit P.S, pasi nuk provohet që të ketë kryer veprën penale për të cilën është dyshuar. Deri në datën 10.03.2023, ky vendim nuk ka marrë formën e prerë.

Data e provimit për lëndën e Menaxhimit Bankar rezulton të ketë qenë data 07.09.2021. Pasi është njohur me shkresën nr. 2565/1 prot., datë 02.09.2021 dhe duke pretenduar se konflikti i interesit mund të deklarohej vetëm nga KE, ankuesi i është drejtuar KE me *e-mail* datë 07.09.2021, nëse kishte marrë ndonjë vendim në lidhje me konfliktin e interesit të pretenduar nga studentja. KE i ka konfirmuar ankuesit me *e-mail* datë 07.09.2021, se nuk kishte marrë asnjë vendim të tillë. Ankuesi ka paraqitur kundërshtimet e tij në lidhje me interpretimin e bërë nëpërmjet shkresës nr. 2565/1 prot., datë 02.09.2021, të rektores së universitetit, të cilat i ka përcjellë nëpërmjet *e-mailit* datë 07.09.2021. Ankuesi thekson ndër të tjera se, deri në datën 04.09.2021 nuk ka patur asnjë çështje gjyqësore të hapur. Procesi i vetëm gjyqësor që i është hapur nga studentja është bërë në datën 04.09.2021 të cilin ai e ka fituar. Ankuesi gjithashtu parashtron se, studentja nuk është regjistruar për provimin e Menaxhimit Bankar, regjistrim i cili është mbyllur në datën 06.09.2021 dhe se një fakt i tillë mjafton për të mbyllur çështjen e konfliktit të interesit.

Në lidhje me pretendimet e paraqitura nga studentja pranë organeve të USHLG për proceset gjyqësore dhe penale të inicuar kundër ankuesit në lidhje me ngjarjen e datës 15.07.2021, këto organe, pra, Rekortja e USHLG dhe KE, kanë depozituar pranë Komisionerit, kopje të procesverbalit “*Mbi kallëzimin me gojë*” të nënshkruar vetëm nga ofriceri i policisë gjyqësore, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër por jo nga studentja në cilësinë e kallëzueses dhe akt mjeko-ligjor nr. 142, datë 19.07.2021, të nënshkruar nga eksperti mjeko ligjor Dh.T, në shërbimin e mjekësisë ligjore Shkodër. Ankuesi pretendoi se këto akte nuk i janë vendosur asnjëherë në dispozicion nga organet e universitetit dhe se ai nuk ka qenë asnjëherë në ndjekje penale. Për këtë qëllim ankuesi ka depozituar vërtetimin nr. 1831 prot., datë 19.05.2023, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, ku vërtetohet se ndaj tij nuk rezulton të ketë procedim penal në hetim, të regjistruar në ngarkim të tij nga viti 2013 deri më datë 19.05.2023.

Në lidhje me kërkesën për ndryshimin e komisionit të riprovimit për lëndët Menaxhim Bankar dhe Modelim Financiar, studentja ka kërkuar informacion nëpërmjet *e-mailit* datë 07.09.2021 drejtuar dekanes së fakultetit ekonomik. Studentja thekson se meqënëse nuk ka marrë përgjigje për shkresën zyrtare që kishte paraqitur nuk është regjistruar për riprovimin e datës 07.09.2021 dhe se, meqënëse një gjë e tillë nuk kishte ndodhur për fajin e saj, t’i mundësohej një datë e dytë për menaxhimin bankar.

Rezulton se, në mbledhjen e datës 07.09.2021, ora 09:00, departamenti i financë-kontabilitetit ka vendosur unanimisht që të mos ndryshojë komisionet e provimeve Menaxhim Bankar dhe Modelim Financiar, duke gjykuar se një vendim ndryshe nga ky do të përbënte precedent dhe për

raste të tjera në të ardhmen. Ky përfundim i departamentit për të mos ndryshuar komisionin e provimeve është marrë për shkak të mungesës së informacionit të duhur dhe vendimeve nga KE dhe organet gjyqësore. (shkresa nr. 897 prot). Ky vendim i është përcjellë rektores së universitetit dhe është protokolluar me nr. 2611 prot., datë 07.09.2021.

Në vijim të procedurës përpara KE, nëpërmjet *e-mailit* të datës 13.09.2021, ankuesi ka kërkuar nga KE informacion mbi shkaqet e mosdërgimit të ankesës që ai kishte paraqitur në KE, informacion në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë nga studentja dhe kopje të regjistrimeve të kamerave të godinës së fakultetit ekonomik, kërkesë të cilën e ka paraqitur edhe në datë 15.07.2021, por nuk është plotësuar.

Ankuesi pretendon se, në datën 14.09.2021 është thirrur në një takim zyrtar me rektoren, zv.rektoren, dekanen dhe shefen e departamentit, ku objekti i takimit ishte kërkesa e studentes për ndërrimin e komisionit të provimeve, sepse në datën 22.09.2021 ishte provimi i Modelimit Financiar, në të cilin ankuesi ishte firmë e dytë. Sipas tij, në këtë takim rektorja shprehu dëshirën për të bërë edhe një herë provimin e Menaxhimit Bankar vetëm për studenten, duke ndërruar komisionin dhe duke hapur një datë tjetër provimi. Kjo kërkesë është kundërshtuar nga ankuesi dhe sipas tij është hedhur poshtë si jo në përputhje me ligjin edhe nga zv.rektorja e cila ishte prezent në takim. Në këto kushte, sipas ankuesit rektorja është shprehur se do ti kërkonte KE që të merrte një vendim para provimit të Modelimit Financiar.

Në vijim, nëpërmjet disa e-maileve datë 14.09.2021 dhe 15.09.2021, ankuesi ka kërkuar informacion në lidhje me seancat e radhës para KE, ka pretenduar se nuk ka marrë asnjë dokument zyrtar përveç kërkesës në mbledhje, ka kërkuar kopje të ankesës dhe kopje të raportit mjeko ligjor nëse studentja kishte dorëzuar një të tillë si dhe një takim sa më shpejt të ishte e mundur me KE. Në vijim, kryetari i KE z. D, i ka kthyer përgjigje akuesit nëpërmjet *e-mailit* po në të njëjtat data, se, KE nuk ka detyrim që të njoftojë për mledhjet e veta dhe as që palët të jenë prezent në këtë fazë, se e kishte informuar ankuesin në lidhje me provat, e kishte dëgjuar atë dhe se ishin të gatshëm për të administruar çdo provë dhe për ta dëgjuar përsëri ankuesin, nëse ai do ta kërkonte një gjë të tillë. Në lidhje me kërkesën e ankuesit për të zhvilluar një takim, z. D, i ka komunikuar ankuesit se, nëse nuk kishte prova të reja për të përcjellë në KE, nuk e shikonte të arsyeshme caktimin e një takimi dhe se KE e kishte përfunduar fazën e mbledhjes së provave dhe të dëshmimeve. Në vijim nëpërmjet *e-mailit* datë 15.09.2021 ka kërkuar takim me KE për të paraqitur prova shtesë. Pas këtij momenti, nuk janë administruar komunikime të mëvonshme midis ankuesit dhe KE.

Me vendimin nr. 291, datë 27.09.2021 (nr. 2937 prot., datë 27.09.2021), KE, ka arritur në përfundimin se: - në lidhje me vlerësimin e provimit, nuk është KE organi të cilit duhet t'i drejtohet studenti, pa ezauruar më së pari kërkesat në organet e tjera të parashikuara nga rregullorja e studimeve; - në lidhje me ankesën e studentes se nuk janë marrë masa nga FE, ne kemi konstatuar se nuk janë bërë ankesa/kërkesa drejtuar FE për marrje masash për zgjidhjen e konfliktit në fjalë; - në lidhje me dëmet fizike të pretenduara nga studentja për të cilat është dorëzuar edhe një akt mjeko-ligjor, KE, pas dëgjimit të dëshmimeve të palëve të përfshira, si dhe pas vlerësimit të provave

filmike të kamerave të USH-së, nuk mund të arrijë në përfundimin se dëmtimi është shkaktuar nga dera e zyrës së pedagogut P.S, siç pretendon studentja. Në përfundim të shqyrtimit, me vendimin nr .291, datë 27.09.2021, KE ka vendosur: *“1. Pushimin e hetimit administrativ për masë disiplinore ndaj pedagogut P.S. 2. Ti komunikohet ky vendim pedagogut P.St dhe studentes E.V. 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë”*. Pas njohjes me këtë vendim, ankuesi ka konstauar se nuk kishte asnjë masë ndaj studentes sipas ankesës që ai kishte dërguar dhe sipas tij KE nuk kishte marrë një vendim përfundimtar por kishte vendosur të pushonte çështjen duke e mbajtur pezull.

Në datën 04.10.2021, ankuesi ka paraqitur një kërkesë me shkrim për informacion (me nr. 3054 prot.), për të marrë një kopje të ankesës, akteve provave, kamerave, në mënyrë që të informohej zyrtarisht për ngjarjen, por nuk ka marrë përgjigje. Po në datën 04.10.2021, ankuesi ka paraqitur një kërkesë për marrjen e masës disiplinore të përjashtimit për 1 vit për studenten E.V, duke u bazuar në vendimin e KE i cili kishte arritur në përfundimin se ngjarja e pretenduar nuk kishte ndodhur. Në këtë kërkesë, ankuesi thekson faktin se, ai kishte paraqitur edhe dy ankesa të tjera në KE dhe në rast se ndonjë nga anëtarët e KE ishte në konflikt interesit me studenten në fjalë, të tërhiqej nga firmosja e çdo lloj vendimi, akti ose dokumenti.

Sipas ankuesit, të nesërmen, rektorja ka mbledhur në mënyrë urgjente drejtuesit e fakultetit ekonomik dhe i ka kërkuar që të krijonin një komision të ri provimi, sepse ajo kishte vendosur që të hapnin 2 data provimi vetëm për studenten. Ankuesi pretendon se me urdhër të rekoresh, është krijuar komisioni i ri i provimit vetëm për studenten duke tentuar në këtë mënyrë që të ofrohej një diplomim urgjent para se KE të shprehej për masë administrative ndaj saj. Në mbështetje të këtij pretendimi, ankuesi ka depozituar në cilësinë e provës një komunikim të zhvilluar midis dekanes së fakultetit ekonomik dhe rektores. Me anë të *e-mailit* të dërguar në datën 05.10.2021, ora 11:43, znj. B.D, dekane e fakultetit të ekonomisë i drejtohet rekoresh së USHLG znj. S.G: *“Në pamundësi për të marrë pjesë në takimin e caktuar sot nga ju, për arsye shëndetësore, u njoftova –mailit nga përgjegjësja e departamentit prof. E, për arsyen e takimit të sotëm. Theksoj edhe një herë se as mua dhe as përgjegjëses së departamentit nuk i ka munguar për asnjë moment angazhimi dhe preokupimi në zgjidhjen e kësaj situate të paprecedentë. Meqënëse kërkohet domosdoshmërisht nga ana juaj, dhënia e mundësisë studentes për zhvillimin e dy provimeve dhe koha është shumë e kufizuar (provimi i diplomës është më datë 7 tetor), kërkohet nga ana juaj një vendim për hapjen e dy datave të cilat nuk kemi të drejtë ti hapim ne, ndërkohë që departamenti dhe dekanati, do të krijojnë kushtet optimale për dhënien e provimeve nga ana e studentes. Gjithashtu nisur nga situata shumë delikate do të kërkoja nga ju që të caktoni vëzhgues për ecurinë e zhvillimit të provimeve. Në pritje të përgjigjes tuaj.”*. Nëpërmjet *e-mailit* të dërguar në datën 05.10.2021, ora 15:04, znj. S.G, rektore e USHLG, i drejtohet dekanes së fakultetit ekonomik: *“ Profe B.! Sillni sa më parë komisionin për dy provimet dhe kërkesën për hapjen e datave”*. Gjatë shqyrtimit të ankesës, nuk u administrua ndonjë kopje urdhri të nxjerrë nga rektorja e universitetit për krijimin e një komisioni të ri provimi vetëm për studenten.

Në datën 14.10.2021 është mbledhur Asambleja e Pedagogëve ku është diskutuar çështja e uljes së numrit të studentëve, sidomos në degën e mësuesisë, që frekuentojnë USHLG, duke kërkuar



reagim nga institucioni. Në cilësinë e anëtarit të kësaj përfaqësie, ankuesi deklaroi se, ka mbajtur një fjalim, ku ka kërkuar që Senati Akademik të fillojë një proces gjyqësor kundër MAS, për të kundërshtuar caktimin e mesatares së lartë për pranimin e studentëve. Sipas tij, në mbledhje kanë folur edhe pedagogë të tjerë, të cilët kanë ngritur akuza për punë të dobët të kolegëve të Universitetit, në përpilimin e programeve të reja studimore për të aplikuar pranë MAS. Nuk ka një dokument zyrtar të shkruar në lidhje me diskutimet e mbajtura gjatë mbledhjes së zhvilluar nga Asambleja e Pedagogëve të USHLG, por fakti rezulton se ka ndodhur pasi është pasqyruar si ngjarje në media.<sup>5</sup> Referuar lajmeve të publikuara në media, në lidhje me deklaratat e bëra nga Asambleja e Pedagogëve, anëtar i të cilit është edhe ankuesi, ka reaguuar Ministria e Arsimit dhe Sportit<sup>6</sup>.

Sipas ankuesit, në datën 15.10.2021, pasi është raportuar se Ministria e Arsimit dhe Sportit ka reaguuar duke deklaruar se nuk ka refuzuar takimin me asamblenë e pedagogëve dhe është e gatshme për takim, në orën 18:00, Rektorja e Universitetit ka njoftuar për takim urgjent në rektorat ku është ftuar për të marrë pjesë në një takim urgjent përfaqësia e asamblesë. Në këtë mbledhje, ankuesi pretendon se Rektorja është shprehur shumë keq në adresë të tij, duke theksuar faktin se *“ankuesi ka cënuar universitetin ku merr rrogën”*, si dhe se ka bërë gabim që ka lexuar të dhënat mbi numrin e studentëve. Në vijim i është tërhequr vëmendje mbi faktin se ka ftuar mediat në këtë takim. Ankuesi sqaron se, në Mbledhjen e Asamblesë ka patur edhe pedagogë të tjerë të cilët kanë folur dhe kanë evidentuar problematika të USHLG, por titullarja e universitetit ka vënë në dukje vetëm fjalimin e tij. Në këtë takim, ankuesi sqaron se ka kundërshtuar Rektoren e Universitetit duke i thënë se në cilësinë e pedagogut, ai ka të drejtë të shprehet lirisht mbi politikën e ndjekura nga institucioni. Ankuesi pretendon se, është shprehur para Rektores se, nëse janë të vendosur ta largojnë nga puna për shkak të qëndrimeve të tij publike, janë të lirë ta kryejnë një gjë të tillë, pasi ai nuk tërhiqet nga deklaratat e tij, të cilat i ka konsideruar se janë në të mirën e universitetit dhe qytetit të tij. Ankuesi shprehet se mbledhja është mbyllur pa i komunikuar vendimin e organit kolegjal, edhe pse ai ka pyetur disa herë mbi vendimmarrjen e tyre. Ankuesi pretendon se, Rektorja e Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, vepron ndryshe kundrejt tij, duke krijuar situata që tentojnë t’a frikësojnë me vërejtje të mundshme dhe tentojnë të ulin figurën e tij para kolegëve.

Në lidhje me pretendimet e parashtruara nga ankuesi për takimin e zhvilluar në datën 15.10.2021, Rektorja e USHLG znj. S.G, nëpërmjet shkresës nr. 800/1 prot., datë 08.03.2023, deklaroi se diskutimet në mbledhjen e Rektoratit të datës 15.10.2021, nuk kanë lidhje me rastin në fjalë. Gjatë shqyrtimit të ankesës nuk u arrit të administrohej ndonjë akt/procesverbal i mbajtur gjatë takimit/mbledhjes së Rektoratit të USHLG, të datës 15.10.2021.

<sup>5</sup> <https://tv1-channel.tv/2021/10/14/nuk-ka-pasur-asnje-kerkese-per-dialog-ministria-e-arsimit-reagon-pas-lajmit-per-mbylljen-e-11-degeve-ne-universitetin-e-shkodres-ja-cfare-kane-kerkuar/>  
<https://www.balkanweb.com/nuk-ka-pasur-asnje-kerkese-per-dialog-ministria-e-arsimit-reagon-pas-lajmit-per-mbylljen-e-11-degeve-ne-universitetin-e-shkodres-ja-cfare-kane-kerkuar/>

<sup>6</sup> Si më sipër.

Ankuesi ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi duke pretenduar se është diskriminuar nga subjektet kundër të cilëve ka paraqitur ankesën, për veprimet dhe mosveprimet respektive të secilit subjekt të paraqitura në ankesë dhe për shkaqet e pretenduara të diskriminimit.

**Bazuar në faktet dhe kronologjinë e ngjarjeve të parashtuara më sipër, si dhe arsyetimin e bërë nga gjykata në vendimin nr. 2145, datë 20.07.2022, në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri ka arritur në përfundimet e mëposhtme, mbi pretendimet për diskriminim të parashtuara nga ankuesi kundrejt subjekteve kundër të cilëve është paraqitur ankesa objekt shqyrtimi:**

- **Në lidhje me vendimarrjen e KE në kuadër të shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga studentja kundër ankuesit, e materializuar në vendimin nr. 291, datë 27.09.2021, të KE.**

Bazuar në provat e administruara rezulton se, gjatë procedurës së zhvilluar nga KE në lidhje me shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga studentja kundër ankuesit, konstatohet se ankuesit nuk i është vendosur në dispozicion kopje e ankesës dhe akteve të depozituara nga studentja para KE në cilësinë e provës. Sikurse rezulton nga njoftimi i datës 30.08.2021, nëpërmjet të cilit KE ka njoftuar ankuesin për tu paraqitur në dëgjësë, nuk ka asnjë informacion në lidhje me objektin e ankesës ose cilësinë në të cilën ankuesi thirrej për të marrë pjesë. Rezulton gjithashtu se, KE nuk i ka vendosur në dispozicion ankuesit aktet që ka administruar në kuadër të shqyrtimit të kësaj ankese, siç janë kamerat dhe dëshmitë e dhëna gjatë dëgjësës së zhvilluar para KE në datën 02.09.2021.

Pavarësisht konstatimeve të mësipërme dhe faktit se gjatë procesit të zhvilluar nga KE, ky i fundit nuk ka respektuar të drejtat e ankuesit si palë e përfshirë në procedurë për t'u njohur me të gjitha aktet dhe provat mbi bazë e të cilave është bazuar vendimarrja e KE, Komisioneri gjykon se, vendimarrja përfundimtare e KE, e materializuar në vendimin nr. 291, datë 27.09.2021, nuk çënon në thelb të drejtat e ankuesit në përfundim të procedurës disiplinore të zhvilluar në ngarkim të tij. Ky konkluzion i arritur nga Komisioneri në lidhje me këtë pretendim të ngritur në ankesë nga ana e ankuesit, nuk është gjykuar i pabazuar nga ana e gjykatës, referuar arsyetimit të bëra nga ana e saj në vendimin nr. 2145, datë 20.07.2022.

- **Në lidhje me mosmarrjen në shqyrtim të ankesave të paraqitura nga ankuesi kundër studentes, për marrjen e masës disiplinore kundër studentes.**

Bazuar në aktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, rezultoi e provuar se në lidhje me ngjarjen e ndodhur në datën 15.07.2021 midis ankuesit dhe studentes E.V, ankuesi ka depozituar 3 ankesa duke pretenduar, një sjellje jo etike nga ana e studentes, e cila kishte çënuar reputacionin e tij jo vetëm në ambientin e punës si pedagog por me ndikim edhe në rrafshin familjar, pasi pretendimet e sajura sipas tij nga studentja ishin shumë të rënda dhe që mund të sillnin reagime të të afërme apo familjarëve. Konkretisht rezultoi e provuar se, ankesa e parë është depozituar nga ankuesi në datën 24.07.2021 dhe është dërguar me *e-mail* në adresën e

rektorese së universitetit znj. S.G, nëpërmjet të cilës referonte sjelljen e studentes gjatë ngjarjes së ndodhur në datën 15.07.2021 dhe kërkonte ndërmarrjen e veprimeve të mëtejshme nga Këshilli i Etikës. Rektorja e Universitetit, nuk rezultoi ta ketë përcjellë këtë ankesë në KE për procedura të mëtejshme dhe nga ana e saj si titullare nuk është ndërmarrë asnjë veprim në lidhje me trajtimin e pretendimeve të paraqitura nga ankuesi kundrejt studentes.

Rezultoi e provuar se në datën 02.09.2021, ankuesi ka përcjellë me *e-mail* tek të gjithë anëtarët e KE, të njëjtën ankesë që kishte paraqitur tek rektorja nëpërmjet *e-mailit* të datës 24.07.2021, pasi ata deklaruan gjatë dëgjësës me ankuesin se nuk iu ishte përcjellë një ankesë e tillë. Pas depozitimit të ankesës tek të gjithë anëtarët e KE nuk rezultoi të jetë ndërmarrë asnjë veprim në lidhje me trajtimin e saj nga ana e këtij organi.

Rezultoi e provuar se, në datën 04.10.2021, pasi kishte përfunduar procedimi disiplinor kundër ankuesit mbi bazën e ankesës së paraqitur nga studentja E.V në datën 19.07.2021, ankuesi ka paraqitur ankesën e tretë, duke kërkuar marrjen e masës disiplinore të përjashtimit për 1 vit ndaj studentes, për shkak të veprimeve që kanë cënuar integritetin profesional të pedagogut dhe shkeljes së rëndë të Kodit të Etikës.

Në mënyrë të vazhdueshme ankuesi ka kërkuar informacion se çfarë veprimesh ishin ndërmarrë në lidhje me ankesat e tij ndaj studentes, por nuk ka marrë asnjë informacion.

Rektorja e USHLG, nuk dha asnjë shpjegim se çfarë masash ishin marrë për trajtimin e ankesave të paraqitura nga ankuesi kundër studentes dhe arsyet se përse ankesat e paraqitura nuk i kishin kaluar për shqyrtim KE. Ndërsa KE, parashtroi se, ankuesi kishte depozituar një ankesë duke kërkuar marrjen e masës disiplinore ndaj studentes E.V, për të cilën KE nuk ka hapur hetim me arsyetimin se studentja ishte çregjistruar nga USH dhe nuk ishte më subjekt i Kodit të Etikës.

Referuar Kodit të Etikës së USHLG<sup>7</sup>, për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave KE shprehet me vendim (neni 7 i Kodit të Etikës). Sipas procedurës së shqyrtimit të ankesave para KE, parashikuar në nenin 9, të Kodit të Etikës, shkeljet i raportohen KE me anë të një ankese ose kërkesë me shkrim dhe kjo mund të bëhet nga çdo subjekt i Kodit të Etikës që konstaton shkelje të këtij kodi. Referuar nenit 3, të Kodit të Etikës, janë subjekte të këtij kodi, stafi akademik, ai ndihmës mësimor, administrativ dhe studentët e USH.

Rezultoi plotësisht e provuar se ankuesi ka dërguar me *e-mail* në adresën e rektorese së universitetit ankesën e parë me shkrim, në datën 24.07.2021, por nuk rezultoi që nga ana rektorese të jenë ndërmarrë masa për përcjelljen e ankesës që ankuesi kishte bërë kundër studentes para KE. Nga aktet e administruara, rezultoi se, studentja ka paraqitur në të njëjtën mënyrë ankesën e saj të datës 19.07.2021 kundër ankuesit, pra nëpërmjet *e-mailit*. Në rastin e ankesës së studentes, rektorja e ka përcjellë këtë ankesë për shqyrtim pranë KE, ndërsa nuk ka vepruar në të

<sup>7</sup> [https://unishk.edu.al/fileadmin/user\\_upload/2022-2023/programi\\_i\\_transparences/Kodi\\_i\\_Etike\\_s\\_-\\_Universiteti\\_i\\_Shkodre\\_s.pdf](https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2022-2023/programi_i_transparences/Kodi_i_Etike_s_-_Universiteti_i_Shkodre_s.pdf)

njëjtën mënyrë me ankesën e bërë nga ankuesi kundër studentes, të cilën nuk e ka përcjellë pranë KE për shqyrtim. Gjatë shqyrtimit të ankesës rektorja e universitetit nuk dha asnjë shpjegim në lidhje me ankesën e datës 24.07.2021 që i është paraqitur nga ankuesi dhe arsyet që e kishin shtyrë rektoren që të mos e përcillte ankesën për shqyrtim para KE.

Rezultoi plotësisht e provuar se në datën 02.09.2021, ankuesi ka ridërguar të njëjtën ankesë, me *e-mail* në adresat elektronike të anëtarëve të KE, por nuk rezultoi që nga ana e KE të jetë ndërmarë ndonjë procedurë për shqyrtimin e saj apo ndonjë vendim në lidhje me pranimin ose refuzimin e ankesës. Në rastin e ankesës së studentes, KE ka kryer shqyrtimin e ankesës dhe në përfundim është shprehur me vendimin nr.291, datë 27.09.2021. Gjatë shqyrtimit të ankesës KE nuk dha asnjë shpjegim në lidhje me ankesën me shkrim të datës 02.09.2021, që i është përcjellë me *e-mail* nga ankuesi. Referuar Kodit të Etikës, për shqyrtimin e kërkesave dhe/ose ankesave KE në çdo rast shprehet me vendim. Në rastin e ankesës së përcjellë nga ankuesi me *e-mail* në datë 02.09.2021, KE nuk ka marrë asnjë vendim për të disponuar në lidhje me këtë ankesë, por e ka lënë atë në heshtje pa asnjë veprim.

Gjatë shqyrtimit të ankesës objekt shqyrtimi, KE parashtrroi se ankuesi ka paraqitur vetëm një ankesë kundër studentes E.V, duke ju referuar këtui ankesës së paraqitur nga ankuesi në datën 04.10.2021, fakt ky që rezultoi i pabazuar. Në lidhje me shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga ankuesi në datën 04.10.2021, KE pretendoi se nuk e ka marrë në shqyrtim dhe nuk ka zhvilluar një hetim, pasi studentja E.V. ishte çregjistruar nga universiteti. Ankuesi prapësoi këtë pretendimin të KE, duke parashtruar se, është i pavërtetë. Sipas ankuesit hera e parë që KE ka pyetur sekretarinë mësimore në fakultetin ekonomik për çregjistrimin e studentes ka qenë muaji dhjetor 2022, fakt ky që del nga shkresa nr.800/1 prot., datë 08.03.2023 e dërguar nga rektorja.

Në mbështetje të pretendimit të KE se nuk është proceduar me shqyrtimin e ankesës së ankuesit të datës 04.10.2021 sepse studentja E.V. është çregjistruar nga universiteti, KE ka përcjellë nëpërmjet shkresës nr.800/2 prot., datë 09.03.2023, vërtetimin nr. 494 prot., datë 07.03.2023 të lëshuar nga Fakulteti Ekonomik i USHLG, sipas të cilit vërtetohet se studentja E.V. është çregjistruar nga ky fakultet me datë 19.10.2021. Referuar shkresës nr. 800/1 prot., datë 08.03.2023, rektorja e USHLG, parashtron gjithashtu se, studentja E.V. është çregjistruar me datë 19.10.2021 dhe në mbështetje të këtij pretendimi ka depozituar bashkëlidhur shkresës komunikimin me *e-mail* të datë 19.12.2022, ku punonjësja B.Gj, i komunikon z. R.D, kryetar i KE se studentja E.V. është çregjistruar me datë 19.10.2021.

Nga aktet e vendosura në dispozicion nga KE, nuk rezultoi që ky organ të jetë vënë në lëvizje për shqyrtimin e ankesës së datës 04.10.2021 të paraqitur nga ankuesi, të ketë administruar në atë kohë ndonjë dokument që vërteton çregjistrimin e studentes dhe bazuar në këtë konstatim të ketë marrë një vendim, për pamundësinë e zhvillimit të procedurës disiplinore për shkak se studentja nuk ishte më subjekt i Kodit të Etikës. Justifikimi i paraqitur nga KE se, nuk ka proceduar me shqyrtimin e ankesës, pasi studentja ishte çregjistruar dhe nuk ishte më subjekt i Kodit të Etikës, është i pabazuar, për sa kohë që KE duke patur detyrimin që të shprehet vetëm me vendim në kuadër të

shqyrtimit të ankesave/kërkesave, nuk ka marrë asnjë vendim në lidhje me ankesës, duke e lënë atë në heshtje pa asnjë vendimmarrje.

Bazuar në nenin 29, të Statutit të USHLG dhe Kodit e Etikës së këtij universiteti, Këshilli i Etikës është organ kolegjal administrativ, i cili promovon dhe shqyrton çështje që lidhen me etikën në procesin mësimor dhe atë kërkimor-shkencor, veprimtaritë e tjera të USH-së dhe me shkeljen e tyre.

Referuar nenit 31 të Statutit të USHLG, Rektori është autoriteti më i lartë akademik i USH-së dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare. Sipas pikës 7, të nenit 31 të Statutit: *“Rektori ka këto detyra dhe kompetenca: a) i paraqet senatit planin strategjik të zhvillimit të USH-së; b) drejton dhe kontrollon veprimtarinë e të gjitha strukturave të USH-së. Siguron unitetin e USH-së dhe është garant i autonomisë universitare brenda USH-së; c) përfaqëson USH-në në marrëdhënie me të tretët, d) ka të drejtë të shfuqizojë vendimet e dekanit kur ato bien ndesh me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, me këtë Statut, me rregulloret e USH-së dhe me vendimet e Senatit; e) garanton zbatimin e akteve ligjore e nënligjore, të Statutit dhe të rregulloreve të brendshme të USH-së;...”*

Ankuesi e drejton ankesën e tij kundër z. R.D, Kryetar i KE. Bazuar në statusin dhe natyrën e KE si një organ kolegjal si dhe referuar pretendimeve të ngritura nga ankuesi në lidhje me mosmarrjen në shqyrtim të ankesave të paraqitura kundër studentes, Komisioneri vlerëson se, përgjegjësia bie mbi KE, në cilësinë e organit kolegjal të ngarkuar për shqyrtimin e ankesave.

**Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, duke mos marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga ankuesi P.S, Rektorja e Universitet të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe Këshillit të Etikës, kanë cënuar të drejtën e tij për të patur një shqyrtim të pretendimeve të tij për cënim të interesave dhe reputacionit të tij nga sjelljet joetike e studentes. Në këtë kuadër, ankuesit i është cënuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, duke iu mohuar të drejtat bazë të këtij procesi siç janë, e drejta për t’u njohur me faktet, provat, për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur. Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankuesi P.S i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, nga ana e Rektores së Universitet të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe Këshillit të Etikës, pranë këtij universiteti, gjatë procesit disiplinor të kërkuar prej tij për mbrojtjen e interesit dhe reputacionit të tij, në kuadër të marrëdhënieve të punës.**

**- Në lidhje me pretendimet e ankuesit për përjashtimin e tij nga komisionet e provimeve.**

Bazuar në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, rezultoi se, kërkesën për përjashtimin e ankuesit nga komisionet e provimeve të lëndëve Menaxhim Bankar dhe Modelim Financiar, e ka paraqitur studentja E.V. në datën 27.08.2021, me arsyetimin se ankuesi ishte në konflikt interesi për shkak të proceseve gjyqësore dhe para KE, që ajo kishte iniciuar kundër tij. Në lidhje me këtë kërkesë të studentes, në datën 31.08.2021, departamenti i financë-kontabilitetit,

pranë fakultetit të ekonomisë, ka kërkuar interpretim juridik nga rektorja e universitetit. Mbi bazën e kërkesës për interpretim juridik të paraqitur nga fakulteti ekonomik, rektorja e universitetit znj. S.G, ka dërguar shkresën nr. 2565/1 prot., datë 02.09.2021, duke interpretuar se, kërkesa e studentes ishte e bazuar dhe se dekan i dhe përgjegjësi i departamentit duhet të marrin masa për të shmangur çdo rrethanë që krijon ose mund të krijojë gjendje të konfliktit të interesit në gjykimin e vlerësimit të studentes. Departamenti i financë-kontabilitetit, ka vendosur në datën 07.09.2021, që të mos i ndryshojë komisionet e provimit për lëndët e kërkuara nga studentja. Ky vendim, nuk rezultoi të jetë shfuqizuar nga ndonjë strukturë eprore.

Ankuesi pretendon se, në datën 14.09.2021, është thirrur nga rektorja një mbledhje në rektorat, ku kanë marrë pjesë, ankuesi, rektorja, zv. rektorja, dekanja e fakultetit ekonomik dhe Përgjegjësj e departamentit financë kontabilitet. Objekt i takimit ishte kërkesa e studentes për ndërrimin e komisionit të provimeve, sepse në datën 22.09.2021 ishte provimi i Modelimit Financiar, në të cilin ankuesi ishte firmë e dytë. Sipas ankuesit, në këtë mbledhje nuk është konkluduar për ndërrimin e komisionit të provimit. Gjatë shqyrtimit të ankesës, rektorja prapësoi se mbledhja në rektorat nuk ka patur si temë diskutimi pretendimet e paraqitura nga ankuesi, por njëkohësisht nuk depozitoi aktin/procesverbalin e mbajtur gjatë takimit të datës 14.09.2021. Nga ana tjetër gjatë shqyrtimit të ankesës nuk u arrit të administrohej ndonjë akt apo provë apo indicie, mbi bazën e të cilës të mund të provohet pretendimi i ankuesit lidhur me kërkesën e rektores për përjashtimin e tij nga komisioni i provimit për lëndën e Modelimit Financiar në datën 22.09.2021.

Në lidhje me regjistrimet audio të depozituara nga ankuesi, ku pretendohet regjistrimi i mbledhjes së zhvilluar në rektorat në datën 14.09.2021, Komisioneri vlerëson se vërtetësia e tyre nuk mund të provohet dhe rrjedhimisht ato nuk mund të merren në cilësinë e provës në kuadër të shqyrtimit të ankesës.

Sipas ankuesit, pasi ai ka paraqitur ankesën kundër studentes në datën 04.10.2021, rektorja ka vazhduar të insistojë duke kërkuar nga strukturat e fakultetit ekonomik që të hapnin data të reja provimesh vetëm për studenten. Pavarësisht se nga korrespondenca me *e-mail* e zhvilluar midis rektores znj. S.G dhe dekanes së fakultetit ekonomik znj. B.D, evidentohet një kërkesë nga ana e rektores për hapje data provimesh dhe krijim të komisioneve, nuk rezultoi që një gjë e tillë të ketë ndodhur dhe nga biseda nuk ka informacion të qartë se për çfarë provimesh bëhet fjalë apo cilët persona janë të përfshirë. Gjatë shqyrtimit të ankesës, nuk u administrua ndonjë akt i nxjerrë nga rektorja e universitetit për krijimin e një komisioni të ri provimi vetëm për studenten apo për përjashtimin e ankuesit nga ndonjë komision provimi.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit se është cënuar dhe paragjykuar nga interpretimi i bërë nga rektorja me shkresën nr. 2565/1 prot., datë 02.09.2021, pavarësisht nga arsyetimi të bërë në këtë shkresë dhe kundërshtimit të ankuesit se kjo shkresë është e pabazuar, ky dokument nuk ka sjellë pasoja për ankuesin, pasi departamenti i financë kontabilitetit ka vendosur që të mos ndryshohen komisionet e provimeve ku ka qenë pjesë ankuesi. Shprehja e qendrimeve ose mendimeve të ndryshme, për sa kohë që ato nuk kanë sjellë pasoja për ankuesin, nuk mund të ngarkojnë me

përgjegjësi subjektin, në kushtet kur vendimarrja që nuk e ka penalizuar ankuesin, është bërë nga një subjekti/strukture tjetër e universitetit, sikurse është departamenti i financë–kontabilitetit, vendim i cili nuk rezulton të jetë rishqyrtuar nga rektorja apo ndonjë strukturë tjetër eprore.

Pretendimet e ankuesit kundrejt znj. V.Z, Drejtore e Drejtorisë Juridike, kanë të bëjnë me shkresën e sipërcituar, duke pretenduar se si konceptuese e shkresës nr. 2565/1 prot., datë 02.09.2021, e ka paragjykuar dhe nuk ka bërë një interpretim të saktë ligjor duke anashkaluar KE. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimit për diskriminim të paraqitur nga ankuesi kundër këtij subjekti, Komisioneri vlerëson se, i njëjti argument i sipërcituar, vlen edhe për pretendimet e ngritura kundër znj.V.Z, Drejtores e Drejtorisë Juridike. Për më tepër, që znj. V.Z, Drejtore e Drejtorisë Juridike, nuk është autoritet apo organ drejtues në USHLG që mund të marri vendime në lidhje me pretendimet e ngritura nga ankuesi.

**Sa më sipër, nuk rezultoi i provuar fakti që ankuesi të jetë përjashtuar nga komisionet e provimeve. Procedura e filluar mbi bazën e kërkesës së studentes për përjashtimin e ankuesit nga komisionet e provimeve, nuk rezulton që të ketë cënuar ankuesin ndërsa pretendimet e ankuesit në lidhje me ndërhyrjet dhe veprimet e rektores për ta përjashtuar ankuesin nga komisionet e provimeve, nuk rezultuan të provuara. Rrjedhimisht, Komisioneri nuk konstaton se ankuesi i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, nga ana e rektores së USHLG, znj. S.G, në lidhje me përjashtimin nga komisionet e provimeve, pasi një fakt i tillë nuk rezulton që të ketë ndodhur dhe ankuesi të jetë përjashtuar nga komisionet ku ka qenë anëtar.**

**Bazuar në aktet dhe provat e administruara, Komisioneri nuk konstaton që sjellja e znj. V.Z, Drejtore e Drejtorisë Juridike, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa, të ketë sjellë pasoja ndaj ankuesit në kuadër të shqyrtimit të pretendimit për diskriminim të ngritur nga ankuesi kundër këtij subjekti.**

- **Në lidhje me pretendimet e ankuesit për qendrimet e mbajtura ndaj tij, nga rektorja e universitetit znj. S.G, gjatë mbledhjes së thirrur në rektorat në datën 15.10.2021.**

Gjatë shqyrtimit të ankesës, rektorja prapësoi se mbledhja në rektorat nuk ka patur si temë diskutimi pretendimet e paraqitura nga ankuesi, por njëkohësisht nuk depozitoi aktin/procesverbalin e mbajtur gjatë takimit të datës 15.10.2021. Gjatë shqyrtimit të ankesës nuk u arrit të provohej ndonjë fakt, provë apo indicie, që do të provonte pretendimet e ankuesit kundrejt rektores së universitetit, në lidhje me sjelljen e saj kundrejt tij, gjatë takimit të zhvilluar në datën 15.10.2021 dhe pretendimet e ankuesit mbetën vetëm të kuadër deklarativ.

Në lidhje me regjistrimet audio të depozituara nga ankuesi, ku pretendohet regjistrimi i mbledhjes së zhvilluar në rektorat në datën 15.10.2021, Komisioneri vlerëson se vërtetësia e tyre nuk mund të provohet dhe rrjedhimisht ato nuk mund të merren në cilësinë e provës në kuadër të shqyrtimit të ankesës.

**Bazuar në aktet dhe provat e administruara, Komisioneri arrin në përfundimin se pretendimet e ankuesit në lidhje me sjelljen dhe qëndrimin e mbajtur nga znj. S.G, rektore e USHLG ndaj ankuesit, gjatë takimit të zhvilluar në rektorat në datën 15.10.2021, nuk mund të provohen. Rrjedhimisht, Komisioneri nuk konstaton se ankuesi i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, nga ana e rektores së USHLG, znj. S.G, në lidhje me sjelljen dhe qëndrimin e mbajtur nga kjo e fundit kundrejt ankuesit P.S, gjatë mbledhjes së zhvilluar në Rektorat në datën 15.10.2021.**

**- Në lidhje me pretendimet për diskriminim ndaj znj. E.Sh, Administratore e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.**

Pretendimi i ankuesit për diskriminim ndaj znj. E.Sh, me detyrë Administratore pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, bazohet në faktin se ky subjekt nuk ka miratuar hapjen e kamerave sipas legjislacionit në fuqi dhe nuk ka bërë asnjë veprim për rikthimin e ligjshmërisë kundrejt pengimit të hapjes së tyre nga Rektorja e këtij universiteti. Nuk ka kthyer përgjigje mbi kërkesat që ankuesi ka dërguar në adresë të saj, sipas legjislacionit në fuqi.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, znj. E.Sh, Administratore e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, nuk ka depozituar parashtrime. Zarfi me shkresën nr. 1268/5 prot., datë 23.11.2022 për njoftimin e seancës dëgjimore, të Komisionerit, drejtuar Administratores së Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, znj. E.Sh, është kthyer mbrapsht me shënimin “*larguar*”.

Nga aktet e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezulton se, ankuesi i është drejtuar me anë të një emaili më datë 16.07.2021, znj. E.Sh, Administratore, znj. S.G, rektore dhe znj. P. H., Zv.rektore duke kërkuar një kopje të kamerave të godinës së fakultetit me datë 15.07.2021 ora 09:00-12:30 dhe 13.07.2021 nga ora 15:45-18:00, për shkak të denoncimit penal që sipas ankuesit kishte bërë në policinë e shkodrës. Në datën 19.07.2021, me anë të e-malit z. I. H, i kërkon znj. S.G konfirmim për sa i përket kërkesës së dërguar me email nga ankuesi për të marrë një kopje të kamerave të godinës së fakultetit ekonomik. Në vijim ankuesi, me email datë 21.07.2021, ka ripërsëritur kërkesën për të marrë një kopje të kamerave. Ankuesit nuk i është vendosur në dispozicion kopja e kamerave të godinës së fakultetit ekonomik, pavarësisht disa kërkesave të tij.

Me shkresën nr. 3677/2 prot., datë 16.09.2021, Komisariati i Policisë Shkodër i është drejtuar Universitetit të Shkodrës me një kërkesë për pamjet filmike në kuadër të hetimeve paraprake mbi ngjarjen e ndodhur në datë 15.07.2021, nga ora 09:30 deri në orën 11:00 të po kësaj date. Me shkresën nr. 2728/ 1 prot., datë 20.09.2021, të rektores së universitetit znj. S.G, pamjet filmike sipas kërkesës i janë dërguar Komisarariatit të Policisë Shkodër.

Vetëm moskthimi i përgjigjes ndaj e-maileve të ankuesit, nuk është i mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se me sjelljen e saj, Administratorja e USHLG, ka diskriminuar ankuesit. Nga aktet e administruara, rezulton se pamjet filmike mund të jepen nëpërmjet rektores, e cila është përfaqësuese ligjore e universitetit me të tretët. Komisioneri çmon se, mosdhënia e informacionit duke përfshirë këtu edhe mosdhënien e kopjes së kamerave, referuar fakteve dhe rrethanave të



çështjes objekt shqyrtimi nuk mund të trajtohet veçmas nga trajtimi që i është bërë cënimit të drejtës së ankuesit për të patur një proces të rregullt ligjor dhe të drejtës së palës për t'u njohur me aktet e dosjes, e cila është trajtuar më sipër. Shqyrtimi i pretendimeve për mosdhënie informacioni jashtë kontekstit të zhvillimit të një procedimi administrativ, nuk hyn në kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, por të autoritetit që garanton të drejtën për informim, sikurse është Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit, rrugë të cilën ankuesi e ka ndjekur.

**Sa më sipër Komisioneri nuk mund të arrijë përfundim se sjellja e znj. E.Sh, Administratore e USHLG e ka diskriminuar ankuesin.**

**- Në lidhje me pretendimin e ankuesit se, pas hapjes së procedimit nga Komisioneri, veprimet e z. R.D dhe znj. B.L, e kanë penalizuar dhe sjellja e tyre vazhdon të prodhojë efekte diskriminuese.**

Në lidhje me këtë moment ankuesi parashtron se, në një shkresë që z. D ka dërguar në muajin janar 2023, si pasojë e ankesës që ankuesi kishte paraqitur në Senatin Akademik ndaj veprimeve arbitrare të z. R.D në krye të KE, vërehen deklaratat komplet ndryshe nga ato të administruara në dosjen e prokurorisë.

Referuar përmbajtjes së *e-mailit* të dërguar nga z. R.D, të cilit i referohet ankuesi, nuk konstatohen shprehje me natyrë diskriminuese. Vetëm fakti që parashtrimi i fakteve i bërë nga z. R.D nuk përputhet sipas ankuesit me të vërtetën sipas tij, nuk është mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se z. R.D, ka konsumuar sjellje diskriminuese nëpërmjet *e-mailit* që ka dërguar, që në fakt është një përgjigje ndaj një e-maili të dërguar paraprakisht nga ankuesi, i cili ka kërkuar përjashtimin e z. D nga KE.

Ankuesi gjithashtu ka parashtruar se, në kërkesën e dytë që ka bërë për shkarkimin e anëtarëve të KE, ka marrë një përgjigje nga anëtarja znj. B.L, të cilën e konsideron si ofenduese, kërcënuese, që përmban deklaratat që nuk janë të vërteta. Referuar përmbajtjes së *e-mailit* të dërguar nga znj. B.L, të cilit i referohet ankuesi, nuk konstatohen shprehje me natyrë diskriminuese. Vetëm fakti që parashtrimi i fakteve i bërë nga znj. L nuk përputhet sipas ankuesit me të vërtetën sipas tij, nuk është mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se jemi para konsumimit të një sjellje diskriminuese, nëpërmjet *e-mailit* që ka dërguar, që në fakt është një përgjigje ndaj një *e-maili* të dërguar paraprakisht nga ankuesi, i cili ka kërkuar përjashtimin e znj. B.L.

## **B. Shkaku i mbrojtur.**

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (neni 18 (2)), askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), garanton të drejtën për të mos u diskriminuar bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të

drejtëpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Në nenin 1 të LMD përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Po ashtu, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, në nenin 9 të tij *“Ndalimi i diskriminimit”*, parashikon: *“Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.”*

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, të LMD, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ky ligj ka bërë në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit, garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura.

Ankuesi pretendon se është diskriminuar nga subjektet kundër të cilëve ka paraqitur ankesën, për më shumë se një shkak dhe konkretisht, për shkak të *“bindjeve filozofike”*, *“gjendjes arsimore”*, *“përkatësisë në një grup të veçantë”* dhe *“çdo shkak tjetër”*.

Në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se shkakun i pretenduar prej saj është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak.

Referuar shpjegimeve të dhëna nga ankuesi lidhur me shkaqet që sipas tij kanë sjellë diskriminimin e tij, ankuesi nuk parashtron në mënyrë të qartë referencën me shkaqet e pretenduara të diskriminimit të identifikuar prej tij, sikurse janë *“bindjeve filozofike”*, *“gjendjes arsimore”*, *“përkatësisë në një grup të veçantë”* dhe *“çdo shkak tjetër”*.

Në vijim, Komisioneri do të vlerësojë në radhë të parë nëse shkaqet e pretenduara nga ankuesi janë shkaqe të mbrojtura nga LMD dhe më pas do të vlerësojë nëse, parashtrimet e bëra nga ankuesi përlligjin dhe provojnë një pretendim për diskriminim bazuar në secilin prej shkaqeve të pretenduara si diskriminuese.

*Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të bindjeve filozofike*, Komisioneri vlerëson se ky shkak parashikohet shprehimisht si një shkak i mbrojtur nga neni 1, i LMD. LMD nuk jep ndonjë përkufizim se çfarë duhet të kuptohet me shkakun *bindje filozofike*. Një përkufizim se çfarë kuptohet me bindje filozofike mungon edhe në praktikën gjyqësore kombëtare. GJEDNJ ka trajtuar konceptin e “bindjes” në kontekstin e së drejtës për arsimim, sipas nenit 2 të Protokollit 1 të KEDNJ, i cili parashikon se shteti duhet të respektojë të drejtën e prindërve për të siguruar që edukimi i fëmijës së tyre të jetë *“në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike”*. GJEDNJ thekson se, në kuptimin e saj të zakonshëm, fjala “bindje”, e marrë në vetvete, nuk është sinonim me fjalët “opinione” dhe “ide”, siç janë përdorur në nenin 10 të Konventës, i cili garanton lirinë e shprehjes, por është më e ngjashme me termin “bindje” që shfaqet në nenin 9, dhe tregon pikëpamje që arrijnë një nivel të caktuar bindjeje, serioziteti, kohezioni dhe rëndësie. Për sa i përket mbiemrit “filozofik”, nuk është e mundur të jepet për një përkufizim shterues<sup>8</sup>.

*Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore*, Komisioneri vlerëson se ky shkak parashikohet shprehimisht si një shkak i mbrojtur nga neni 1, i LMD. LMD nuk jep ndonjë përkufizim se çfarë duhet të kuptohet me shkakun e gjendjes arsimore. Në praktikën e tij Komisioneri ka vlerësuar se, se diferencat në trajtim që bazohen në nivelin e arsimit të një personi<sup>9</sup> ose nivelin e arritjeve në arsim të një personi ose e thënë ndryshe në vlerësimet apo notat e përfituara gjatë ndjekjes së arsimit<sup>10</sup>, do të konsiderohen si diferencë në trajtim që bazohet në gjendjen arsimore. Komisioneri vlerëson se, *gjendja arsimore si shkak diskriminimi*, nënkupton diferencën në trajtim dhe trajtimin më pak të favorshëm që një person i nënshtrohet për shkak të nivelit individual të arsimit, arritjeve të tij në arsim, aftësive, certifikatave ose diplomave që një person posedon.

*Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë*, Komisioneri vlerëson se ky shkak parashikohet shprehimisht si një shkak i mbrojtur nga neni 1, i LMD. LMD nuk jep ndonjë përkufizim se çfarë duhet të kuptohet me këtë shkak, por në praktikën e tij, Komisioneri ka interpretuar se, përkatësia dhe gëzimi i statusit si i përndjekur politik, konsiderohet se përlligj pretendimin e një personi për diskriminim për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë<sup>11</sup>.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh. Në nenin 1, LMD liston një sërë

<sup>8</sup> Shiko: GJEDNJ, Çështja *Campbell dhe Cosans kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 7511/76 dhe 7743/76, 25 Shkurt 1982, prg. 36.

<sup>9</sup> Shiko: Vendimi nr. 147, datë 26.10.2020, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

<sup>10</sup> Shiko: Vendimi nr. 48, datë 19.05.2020, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

<sup>11</sup> Shiko: Vendimi nr. 135, datë 02.10.2019, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin “*çdo shkak tjetër*”, çka do të thotë se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i LMD është në linjë me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh. Krahas praktikës kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statute të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. I njëjti arsyetim mund të shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të LMD dhe pretendimet për shkaqet diskriminuese të paraqitura nga ankuesi.

### **Duke u bazuar në sa më sipër dhe në referim të pretendimeve dhe parashtimeve të paraqitura nga ankuesi, Komisioneri vlerëson se:**

Pretendimet e ngritura nga ankuesi se diskriminimi i tij ka ndodhur pasi, për shkak të formimit të tij si student i diplomuar në një universitet perëndimor dhe fitues i Programit “Brain Grain”, ai nuk pranon ndërhyrje nga të tretët për favorizimin e studentëve në provime, nuk pranon të vendosë notë kaluese të pamerituar, se ai ka kundërshtuar çdo shkelje të ligjit kur ka dëmtuar studentët dhe universitetin apo çdo politikë të gabuar të drejtuesve të universitetit, senatit akademik dhe bordit të administrimit, nuk përlligjin ekzistencën e shkakut të bindjeve filozofike, pasi ato nuk janë pikëpamje që arrijnë një nivel të caktuar bindjeje, serioziteti, kohezioni dhe rëndësia, e rrjedhimisht Komisioneri vlerëson se shkak i pretenduar nga ankuesi është i pabazuar. Favorizimin e studentëve në provime apo vendosja e një notë kaluese të pamerituar, do të përbënte një sjellje në kundërshtim me rregullat administrative, duke mos përjashtuar edhe përgjegjësinë penale të personit. Pretendimi për pasjen e një sjellje brenda kufijve të ligjshmërisë, nuk mund të konsiderohet një “bindje”. Gjithashtu, konstatohet që ka dhe lektorë të tjerë në USHLG që kanë mbaruar studimet në universitete perëndimore. Komisioneri vlerëson të pabazuar edhe pretendimin për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore, ku ankuesi pretendon se, sjellja e tij është për shkak të formimit të tij në një universitet perëndimor dhe se është fitues i Programit “Brain Gain”.

Në datën 24.01.2023, nëpërmjet një sqarimi shtesë në lidhje me shkaqet e diskriminimit ankuesi shprehet se, ankesa e studentes ndaj tij ishte për shkak të karakteristikave që ai posedon, se nuk

toleron favorizime. Sipas tij, një fakt i tillë provohet nga deklaratat e bëra nga studentja gjatë procesit gjyqësor që ajo ka zhvilluar kundër ankuesit, ku ka deklaruar se është favorizuar nga të gjithë pedagogët (edhe strukturat drejtuese) ndërsa ankuesi nuk e kishte bërë një gjë të tillë. Ankuesi kërkon që sa më sipër, të pranohet të shkaqet e diskriminimit që ai ka cituar si pjesë e programit Brain Gain, ku ka theksuar se ai nuk pranon ndërhyrje për provime dhe favorizime në kundërshtim me ligjin. Komisioneri vlerëson se, këto pretendime të ankuesit nuk përmbajnë pretendime shtesë nga ato të parashtruara më herët nga ankuesi, të cilat bazuar në arsyetimin e mësipërm, janë vlerësuar si të pabazuara.

*Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë, bazuar në provat e administruara rezultojnë se ankuesi gëzon statusin si i përndjekur dhe rrjedhimisht vërtetohet plotësisht se ankuesi e mbart shkakun e përcaktësisë në një grup të veçantë.*

Ankuesi pretendon se është diskriminuar për shkaqe diskriminuese të cilat nuk citohen shprehimisht nga neni 1 i LMD, duke pretenduar diskriminim në kuadër të “çdo shkakut tjetër”. Duke marrë në analizë pretendimet e parashtruara nga ankuesi, te Komisioneri vlerëson si më poshtë :

Ankuesi pretendon si shkak diskriminimi konfliktin e interesit që ekziston ndërmjet drejtuesve të universitetit dhe anëtarëve të KE me studenten E.V. Sipas ankuesit studentja E.V. ka lidhje shoqërore dhe familjare me anëtarin e KE, z. B.L dhe Rektoren znj. S.G. Për këtë arsye ajo është favorizuar duke mos u trajtuar asnjë nga ankesat që ankuesi ka paraqitur kundër studentes në KE.

Shkakun i mbrojtur, është një cilësi, status apo gjendje që duhet të mbartet nga personi që pretendon se është diskriminuar. Sipas nenit 3, të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar, konflikti i interesit përkufizohet si vijon: “1. “Konflikti i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike.” Sa më sipër dhe bazuar në kriteret mbi bazën e të cilave vlerësohet nëse një shkak përbën një shkak të mbrojtur nga diskriminimi, Komisioneri vlerëson si të pabazuar pretendimin e ankuesit se, konflikti i interesit që ekziston ndërmjet drejtuesve të universitetit dhe anëtarëve të KE me studenten E.V përbën një shkak diskriminues në kuptim të LMD.

*Në parashtrimet e tij lidhur me shkaqet e diskriminimit ankuesi shprehet se, ai ka kundërshtuar çdo shkëlqje të ligjit që sipas tij ka dëmtuar studentët dhe universitetin si dhe ka kundërshtuar dhe kritikuar çdo politikë të gabuar të drejtuesve të universitetit, senatit akademik dhe bordit të administrimit, duke i bërë këto edhe në mënyrë publike. Këto pretendime të ankuesit nuk përlligjin ekzistencën e shkakut të bindjeve filozofike, por bazuar në praktikën e tij Komisioneri ka vlerësuar se, konstatimi i problematikave apo mbajtja e qëndrimeve kritike të shprehura për shkak të*

*detyrës/profesionit<sup>12</sup>, si dhe denoncimi i situatave në shkelje të ligjit, të bëra për shkak të detyrës<sup>13</sup>, janë shkaqe të mbrojtura sipas LMD, në kuadër të “çdo shkakut tjetër.*

Bazuar në aktet e administruara, rezultoi e provuar se ankuesi gjatë detyrës së tij si pedagog pranë USHLG ka konstatuar problematika, ka mbajtur qëndrime kritike dhe ka denoncuar situata të pretenduara në kundërshtim me ligjin, që kanë lidhje me të drejtat e studentëve si dhe politikën dhe mbarëvajtjen e punës në këtë universitet, duke përfshirë ndër të tjera çështje që kanë të bëjnë me tarifën e studentëve, mosfrimin e ngrohjes për studentët, përlllogaritjen e gabuar të të ardhurave dhe shpenzimeve, problematika në lidhje me zbatimin e rregullores së studimeve në universitet, keqmenaxhimin i cili ka shkaktuar rënien e numrit të studentëve, duke rrezikuar mbylljen e degëve<sup>14</sup>. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, bazuar në provat dhe aktet e administruara, rezultoi plotësisht e provuar se ankuesi e mbart shkakun e mbrojtur sipas LMD në kuadër të “çdo shkakut tjetër” atë të konstatimit të problematikave, mbajtja e qëndrimeve kritike të shprehura gjatë detyrës dhe për shkak të detyrës/profesionit, si dhe denoncimi i situatave në shkelje të ligjit, të bëra gjatë detyrës dhe për shkak të detyrës/profesionit.

### **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë me shkaqet e mbrojtura.**

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit “*Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional*”.

Gjykata Kushtetuese<sup>15</sup>, ka mbajtur qëndrimin se: “*E drejta për punë, që garanton neni 49/1 i Kushtetutës, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës dhe sistemin e kualifikimit profesional me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetuese, përbën një të drejtë të individit në kuptimin, që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës. Kjo e drejtë e individit për të*

<sup>12</sup> Shiko: Vendimi nr. 151, datë 11.8.2021, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

<sup>13</sup> Shiko: Vendimi nr. 113, datë 26.08.2019, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

<sup>14</sup> Çështjet dhe problematikën e adresuar nga ankuesi janë parashtruar nëpërmjet disa e-maileve të administruara në dosje, ndër të tjera: e-mail datë 11.01.2021, në lidhje me mungesën e ngrohjes dhe tarifën studentore, e-mail datë 12.05.2020, në lidhje me shkresën e Universitetit lidhur me takimin on-line të Senatit të USHLG, me MASR mbi çështjen e vendosjes së mesatares për pranim në IAL nga MASR, e-mail datë 10.03.2020, ankesë në lidhje me tarifën vjetore të shkollimit dhe zbatimin e VKM nr. 288, datë 21.05.2018 dhe VKM nr. 778 datë 28.12.2018, e-mail datë 28.01.2020 dhe 04.03.2020, përcjellja e problematikës për mungesë ngrohje të ambienteve për studentët; e-mail datë 29.02.2020 në lidhje me adresimin e problematikave në rregulloren për mbajtjen dhe zënieën e vendit të punës në USHLG; e-mail datë 26.02.2020, adresimi i problematikave në Statut dhe Rregulloren e Studimeve të Universitetit, e-mail datë 19.03.2020, parashtrimi i kërkesave për bllokim të shpenzimeve në kuadër të situatës së shkaktuar nga Covid-19.

<sup>15</sup> Vendimi nr. 20, datë 11.07.2006, i Gjykatës Kushtetuese.

*përfitur me punë të ligjshme fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi. E drejta për punë dhe liria e profesionit nënkuptojnë të drejtën e individit për të ushtruar çdo veprimtari të ligjshme që i sjell të ardhura dhe që nuk ka afat të përcaktuar, me përjashtim të rregullimeve të veçanta ligjore. Në këtë kuptim, veprimi i organeve shtetërore që sjell pasoja të drejtpërdrejta në pengimin e veprimtarisë profesionale përbën cenim të kësaj lirie veprimi. Garancia që Kushtetuta i jep individit lidhur me të drejtën për punë dhe lirinë e profesionit ka si qëllim mbrojtjen e këtyre nga kufizimet e papërligjura të shtetit. Liria e profesionit nuk është thjesht një e drejtë për të pasur një vend pune. Ajo nuk duhet kuptuar vetëm si e drejtë sociale, por dhe si liri negative që nuk lejon ndërhyrjen ose pengimin e shtetit gjatë ushtrimit të saj. Përcaktimi që neni 49 i Kushtetutës i bën të drejtës për punë duhet të merret në kuptim të dyfishtë. Ajo përbën një detyrim pozitiv që kërkon angazhimin shtetëror për të krijuar kushte të përshtatshme për realizimin e një të drejte të tillë, por edhe detyrim negativ, i cili kërkon mosndërhyrjen e shtetit për të cenuar këtë të drejtë”.*

Në rastin në fjalë kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune midis një institucioni të arsimit të lartë publik dhe individit, e cila rregullohet nga Kodi i Punës. Parimi i mosdiskriminimit, përshkon në frymë dhe në nene këtë akt rregullator, i cili në pikën 1, të nenit 9, të tij ka përcaktuar se: *“Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”.*

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për punë si një të drejtë të veçantë, por çështjet e punës trajtohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ-ja) si çështje që hyjnë në sferën e veprimit të nenit 8, *“E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare”.* Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë shoqëruese shkaqesh. Ndërkohë Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: *“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.*

E drejta për punë dhe mbrojtja nga diskriminimi në gëzimin e kësaj të drejte parashikohet edhe në akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria të tilla si:

*“Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore”<sup>16</sup>, i cili sanksionon të drejtën për punë në nenin 6, të tij. Sipas këtij akti ndërkombëtar në fushën e të drejtave të njeriut, i cili është ratifikuar nga vendi ynë, parashikohet se, e drejta për punë përfshin të drejtën e secilit për të pasur mundësinë e sigurimit të jetesës, duke punuar punën e pranuar lirisht dhe marrjen e*

<sup>16</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 7511 datë 08.08.1991.

masave të përshtatshme për ta mbrojtur këtë të drejtë. Sipas nenit 2/2, të Paktit, të drejtat e parashikuara në këtë Pakt duhet të garantohen pa asnjë diskriminim.

Konventa Nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “*Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit*”<sup>17</sup>, përcakton parimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në fushën e punësimit dhe të profesionit për të gjithë individët, pa asnjë lloj diskriminimi. Konventa e përkufizon diskriminimin si - çdo dallim tjetër, përjashtim ose preferencë që çon në prishjen apo shtrembërimin e barazisë, të mundësisë ose trajtimit në drejtim të punësimit ose të profesionit.

Karta Sociale Europiane<sup>18</sup> në nenin 1, pika 2, parashikon: “*Me synimin që të sigurohet ushtrimi efektiv i së drejtës për punë, Palët angazhohen.....2 të mbrojnë efektivisht të drejtën e punëtorit për të fituar jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht...*” Ky parashikim, është interpretuar vazhdimisht nga Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale (KEDS) si vendosje e një të drejte për të mos u diskriminuar në punësim<sup>19</sup>. Garancitë për mbrojtjen nga diskriminimi parashikohen në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane, ku përcaktohet shprehimisht mbrojtja nga diskriminimi për cilindo nga shkaqet e mbrojtura.

LMD, parashikon shprehimisht parimin e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimin, parime të cilat janë të ndërthurura ngushtë. Parimi i barazisë kërkon që situata të barabarta trajtohen në mënyrë të barabartë dhe situata të jo të barabarta të mënyrë të ndryshme. Dështimi për ta bërë këtë, konsiderohet diskriminim, përveç nëse ekzistojnë arsye objektive dhe të arsyeshme<sup>20</sup>.

Sipas nenit 3, pika 1 të LMD, diskriminimi përkufizohet si, çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Bazuar në nenin 9/1, të Kodit të Punës, ndalohet çdo formë diskriminimi në ushtrimin e të drejtës për punësim dhe profesion, sipas parashikimeve të bëra në Kod dhe ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.

Në bazë të LMD, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në nenin 6, të tij, përcaktohet se: “*Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi*”.

<sup>17</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

<sup>18</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 8960, date 24.10.2002

<sup>19</sup> Shih: Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë, prg 30.

<sup>20</sup> Raporti Shpjegues që shoqëron Protokollin 12 të KEDNJ-së, prg 15.



Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t'i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës. Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin nenin 33, pika 7/1 të LMD, ku parashikohet se : *“7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.”* I njëjti rregullim në lidhje me barrën e provës, parashikohet edhe në nenin 9, pika 10, të Kodit të Punës, ku përcaktohet se: *“10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”*.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

- Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
- Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njëri nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin<sup>21</sup>.

<sup>21</sup> [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf), fq.232.

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është bazuar pikërisht në standartin e mësipërm të të provuarit, gjatë shqyrtimit dhe konkluzioneve të arritura, në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se, duke mos marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga ankuesi ankuesi P.S, Rektorja e Universitet të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe Këshillit të Etikës, kanë cënuar të drejtën e tij për të patur një shqyrtim të pretendimeve të tij për cënim të interesave dhe reputacionit të tij nga sjelljet joetike të studentes. Në këtë kuadër, ankuesit i është cënuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, duke iu mohuar të drejtat bazë të këtij procesi siç janë, e drejta për t’u njohur me faktet, provat, për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur. Komisioneri arriti në përfundimin se, ankuesi P.S i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, nga ana e Rektores së Universitet të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe Këshillit të Etikës, pranë këtij universiteti, gjatë procesit disiplinor të kërkuar prej tij për mbrojtjen e interesit dhe reputacionit të tij, në kuadër të marrëdhënieve të punës. Nga ana tjetër, rezultuan të bazuar dhe të provuar shkaqet e diskriminimit të pretendua nga ankuesi, siç është përkatësia në një grup të vecantë/ përkatësia si i përndjekur politik dhe në kuadër të “çdo shkak tjetër”/konstatimi i problematikave, mbajtja e qëndrimeve kritike të shprehura gjatë detyrës dhe për shkak të detyrës/profesionit, si dhe denoncimi i situatave në shkelje të ligjit, të bëra gjatë detyrës dhe për shkak të detyrës/profesionit. Në këto kushte, Komisioneri do të marrë në analizë lidhjen midis trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë të cilit i është nënshtruar ankuesi nga ana e Rektores së Universitet të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe Këshillit të Etikës, pranë këtij universiteti, gjatë procesit disiplinor të kërkuar prej tij për mbrojtjen e interesit dhe reputacionit, në kuadër të marrëdhënieve të punës dhe shkaqeve të pretenduara të diskriminimit të cilat rezultuan të bazuara dhe të provuara.

Në lidhje me pretendimet e tjera të parashtruara në ankesë si dhe pretendimet kundrejt subjekteve të tjera kundër të cilëve ankuesi ka drejtuar ankesën, Komisioneri nuk arriti të konstatojë trajtim të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë të ankuesit. Rrjedhimisht këto pretendime dhe subjektet e tjera kundër të cilëve është paraqitur ankesa nuk do të merren në analizë në pjesën vijuese të këtij vendimi.

Në parashtrimet e tij lidhur me shkaqet e pretenduara të diskriminimit, ankuesi e lidh shkakun e përkatësisë si i përndjekur politik me faktin se në çdo rast që ai fiton diçka këto vitet e fundit i hiqet me pa të drejtë. Në këtë kontekst, pretendimet e ankuesit referojnë në vendimin nr. 135 datë 2.10.2019, ku Komisioneri ka konstatuar diskriminimin e ankuesit nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në kuadër të procedurës për përzgjedhjen e kandidaturës fituese të përfaqësuesve të studentëve në Bordin e Administrimit të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër. Vendimi i sipërcituar të cilit i referohet ankuesi nuk ka lidhje me pretendimet objekt i kësaj ankese dhe subjektet kundër të cilëve ajo drejtohet.

Nga aktet e administruara, rezulton se gjatë viteve 2021-2022, në disa raste ankuesi gjatë detyrës së tij si pedagog pranë USHLG ka konstatuar problematika, ka mbajtur qëndrime kritike dhe ka denoncuar situata të pretenduara në kundërshtim me ligjin, që kanë lidhje me shkeljen e të drejtave të studentëve, si dhe politikat dhe mbarëvajtjen e punës në këtë universitet, duke përfshirë ndër të tjera çështje që kanë të bëjnë me tarifat e studentëve, mosofrimin e ngrohjes për studentët, përlllogaritjen e gabuar të të ardhurave dhe shpenzimeve, problematika në lidhje me zbatimin e rregullores së studimeve në universitet, keqmenaxhimin i cili ka shkaktuar rënien e numrit të studentëve, duke rrezikuar mbylljen e degëve.

Ankuesi pretendon se është diskriminuar për më shumë se një shkak dhe pretendimet për diskriminim i drejton kundër disa subjekteve.

Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur pretendimi për diskriminim për shkak të përkatësisë si i përndjekur politik bazohet në vendimin nr. 135 datë 2.10.2019 të Komisionerit dhe se ky vendim nuk ka lidhje me pretendimet për diskriminim objekt i kësaj ankese dhe me subjektet kundër të cilëve drejtohet ankesa, Komisioneri vlerëson se në këto kushte, nuk mund të ngrihen prezumime për diskriminim për shkakun e përcaktësisë në një grup të veçantë, përkatësinë si i përndjekur politik.

Në rastin konkret argumentat dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesi janë në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe krijojnë prezumimin se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga Rektorja e USHLG, znj. S.G kundrejt ankuesit në lidhje me shkakun e diskriminimit të pretenduar në kuadër të çdo shkakut tjetër/konstatimi i problematikave, mbajtja e qëndrimeve kritike të shprehura gjatë detyrës dhe për shkak të detyrës/profesionit, si dhe denoncimi i situatave në shkelje të ligjit, të bëra gjatë detyrës dhe për shkak të detyrës/profesionit, dhe si pasojë barra e provës bie tek këta subjekte.

Në këto kushte, Rektorja e USHLG, znj. S.G, e cila kishte barrën e provës që të provonte, ose që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të diskriminimit dhe trajtimit të pafavorshëm, ose duke provuar se, megjithëse trajtimi i pafavorshëm është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv, në mënyrë që hidhnin poshtë pretendimet e ankuesit se këto veprime janë kryer për shkak të shkakut diskriminues/konstatimit të problematikave, mbajtja e qëndrimeve kritike të shprehura gjatë detyrës dhe për shkak të detyrës/profesionit, si dhe denoncimi i situatave në shkelje të ligjit, të bëra gjatë detyrës dhe për shkak të detyrës/profesionit, situata dhe problematika që kanë lidhje me të drejtat e studentëve si dhe politikat dhe mbarëvajtjen e punës në këtë universitet, duke përfshirë ndër të tjera, çështje që kanë të bëjnë me tarifat e studentëve, mosofrimin e ngrohjes për studentët, përlllogaritjen e gabuar të të ardhurave dhe shpenzimeve, problematika në lidhje me zbatimin e rregullores së studimeve në universitet, keqmenaxhimin i cili ka shkaktuar rënien e numrit të studentëve, duke rrezikuar mbylljen e degëve. dhe si pasojë barra e provës bie tek ky subjekt. Gjatë shqyrtimit të ankesës, Rektorja e USHLG, znj. S.G nuk arriti të provojë se mosmarrja në shqyrtim e ankesave të paraqitura nga ankuesi kundër studentes nuk kishte asnjë lidhje shkakësore me shkakun e diskriminimit të pretenduar nga

ankuesi, ndërsa justifikimet e paraqitura në lidhje me mostrajtimin e këtyre ankesave rezultuan plotësisht të pabazuara. Në mungesë të një justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm lidhur me veprimet e Rektores së USHLG, znj.S.G, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë të cilit i është nënshtruar ankuesi në lidhje me mosmarrjen në shqyrtim të ankesave të tij kundër studentes, mbetet shkaku i diskriminimit.

Në lidhje me trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe jo të barabartë të cilit i është nënshkruar ankuesi nga ana e KE, bazuar në tërësinë e provave të administruara, Komisioneri gjykon se, nuk jemi në kushtet që mund të prezumohet se një trajtim i tillë nga ana e KE ka ardhur për shkakun e mbrojtur. Problematikat e konstatuara, qëndrimet apo denoncimi i situatave në shkelje të ligjit, të bëra nga ankuesi nuk kanë të bëjnë me veprimtarinë e KE, si një organ kolegjal i ngarkuar me shqyrtimin e pretendimeve për shkelje të Kodit të Etikës. Çështjet që ankuesi adreson ndaj anëtares së KE, znj. B.L, janë të pamjaftueshme për të ngritur prezumimin për diskriminim, në kushtet kur KE është një organ kolegjal. Nga ana tjetër, bazuar në provat e administruara, nuk provohet se, vendimarrja e KE është marrë në kushtet e ndikimit apo udhëzimeve të rektores. Komisioneri vlerëson se, faktet dhe provat e administruara, janë të pamjaftueshme për të ngritur një prezumim *prima facie* për diskriminim kundër KE dhe në këto kushte, KE-së nuk mund t'i kalojë barra e provës që të provojë se trajtimi i padrejtë dhe i disfavorshëm nuk është diskriminues.

Në kushtet kur ndalimi i diskriminimit është një e drejtë kushtetuese, e detyrueshme për t'u zbatuar drejtpërsëdrejti nga institucionet, është një e drejtë e garantuar nga Kodi i Punës, është një e drejtë e mbrojtur shprehimisht me ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar, është e natyrshme që kjo e drejtë vendos detyrime negative për të ndërmarrë veprime në përputhje me të drejtën e punëmarrësve për mbrojtjen nga diskriminimi. Në rastin konkret, konstatimi i problematikave, mbajtja e qëndrimeve kritike të shprehura gjatë detyrës dhe për shkak të detyrës/profesionit, si dhe denoncimi i situatave në shkelje të ligjit, të bëra gjatë detyrës dhe për shkak të detyrës/profesionit nga ana e ankuesit përbëjnë shkak diskriminues, sa kohë që Rektorja e USHLG znj. S.G, ka dështuar të japi shpjegime alternative e të besueshme se trajtimi i padrejtë, i pafavorshëm dhe i pabarabartë i ankuesit në lidhje me mosmarrjen në shqyrtim të ankesave të paraqitura kundër studentes, nuk është bërë për shkakun e pretenduar ose është bërë në prani të rrethanave objektive dhe të justifikueshme.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se Rektorja e USHLG znj. S.G, ka diskriminuar ankuesin në të drejtën e tij për punësim, gjatë procesit disiplinor të kërkuar prej tij kundër studentes, për mbrojtjen e interesit dhe reputacionit të tij, duke mos i marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga ankuesi ndaj studentes, për shkak të konstatimit të problematikave, mbajtjes së qëndrimeve kritike të shprehura gjatë detyrës dhe për shkak të detyrës/profesionit, si dhe denoncimit të situatave të pretenduara në shkelje të ligjit, të bëra gjatë detyrës dhe për shkak të detyrës/profesionit nga ana e ankuesit. Për rrjedhojë, Rektorja e USHLG znj. S.G, ka shkelur dispozitat e ligjit nr.10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar.

Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë të ankuesit në lidhje me pretendimet e tjera të parashtruara në ankesë dhe ndaj subjekteve të tjerë kundër të cilëve ka paraqitur ankesën, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të LMD, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”. Në nenin 33, pika 12, të LMD-së, përcaktohet se: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar ndaj ankuesit, duhet të jetë marrja e masave për të mos përsëritur në të ardhmen situata të ngjashme dhe për të trajtuar me efektivitet dhe mbi baza të barabarta çdo ankesë që paraqitet nga çdo subjekt i Kodit të Etikës pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Gjithashtu, në funksion të rregullimit të situatës dhe parandalimit të situatave të ngjashme në të ardhmen, strukturat përgjegjëse të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” duhet të bëjnë hartimin e një Kodi Etike të qartë me procedura dhe afate të qarta për trajtimin e ankesave me efektivitet dhe transparencë.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit të ankuesit P.S, nga ana e znj. S.G, Rektore e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në të drejtën për punësim, gjatë procesit disiplinor të kërkuar prej tij kundër studentes, për mbrojtjen e interesit dhe reputacionit të tij, duke mos i marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga ankuesi ndaj studentes, për shkak të konstatimit të problematikave, mbajtjes së qëndrimeve kritike të shprehura gjatë detyrës dhe për shkak të detyrës/profesionit si dhe denoncimit të situatave të pretenduara në shkelje të ligjit, të bëra gjatë detyrës dhe për shkak të detyrës/profesionit nga ana e ankuesit.
2. Rektorja e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe të gjitha strukturat përgjegjëse pranë këtij Universiteti, të marrin masa për të mos përsëritur në të ardhmen situata të ngjashme dhe për të trajtuar me efektivitet dhe mbi baza të barabarta çdo ankesë që paraqitet nga çdo subjekt i Kodit të Etikës pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.
3. Të merren masa nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” për trajtimin e ankesave të

ankuesit adresuar organeve të Universitetit.

4. Të merren masa nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” për hartimin e një Kodi Etike të qartë me procedura dhe afate të qarta, për trajtimin e ankesave me efektivitet dhe transparencë.
5. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit P.S, nga ana e Këshillit të Etikës pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.
6. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit P.S, në lidhje me pretendimet dhe shkaqet e tjera të diskriminimit të parashtruara në ankesë, si dhe ndaj subjekteve të tjerë kundër të cilëve ka paraqitur ankesën, znj. V.Z, Drejtore Juridike, pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, znj. E.Sh, Administratore e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe z. R.D, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Etikës, pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.
7. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Rektorja e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe strukturat e tjera përgjegjëse të këtij Universiteti, të ngarkuara me marrjen e masave si më sipër, detyrohen që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojnë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
8. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
9. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

